

LISTË E SHKURTIMEVE

HYRJE

STRATEGJIA KOMBËTARE E RINISË
GRUPI I EKSPERTËVE

STRUKTURA

KUSHTET AKTUALE
VIZIONI, PËRPARËSITË DHE QËLLIMET STRATEGJIKE
POLITIKAT
RRJEDHOJAT DHE BURIMET
LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE

PËRMASAT STRATEGJIKE

BASHKËRENDIMI NDËRSEKTORIAL DHE ANGAZHIMI I
PËRBASHKËT
PËRFAQËSIMI DHE PJESËRMARRJA RINORE
TË RINJTË DHE EKONOMIA
SHËNDETI DHE MBROJTJA SOCIALE
REKREACIONI RINOR DHE KOHA E LIRË
TË RINJTË SHQIPTARË: QYTETARËT E RINJ EUROPIANË

SHËNIM: PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT

Listë e dokumenteve të rëndësishëm

I. BASHKËRENDIMI NDËRSEKTORIAL DHE ANGAZHIMI I PËRBASHKËT

1. Forcimi i bashkëpunimit ndërsektorial
2. Sinergjitë e proceseve integruese
3. Këshilli Rinor Shqiptar

II. PËRFAQËSIMI DHE PJESËRMARRJA RINORE

1. Të rinjtë në jetën publike
2. Zhvillimi i kapaciteteve të organizatave rinore
3. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar
4. Pjesëmarrja e të rinjve në votime

III. TË RINJTË DHE EKONOMIA

1. Punësimimi i të rinjve
 2. Thithja e trurit: Të rinjtë që studiojnë jashtë vendit
 3. Biznesi rinor dhe vetëpunësimi
 4. Formimi profesional i të rinjve
- Aftësimi si konsumator i të rinjve

IV. SHËNDETI DHE MBROJTJA SOCIALE

1. Shëndeti riprodhues (lufta kundër HIV/AIDS dhe SST-ve).
2. Abuzimi me drogat
3. Kriminaliteti rinor
4. Dhuna ndaj të miturve dhe të rinjve
5. Trafikimi dhe shfrytëzimi i të rinjve

V. REKREACIONI RINOR DHE KOHA E LIRË

1. Karta e Studentit
2. Koha e lirë , sporti dhe kultura
3. Edukimi dhe aksioni mjedisor
4. Të rinjtë dhe turizmi shqiptar

VI. TË RINJTË SHQIPTARË: QYTETARËT E RINJ EUROPIANË

1. Edukimi qytetar dhe demokracia
2. Roli i rinisë në promovimin e të drejtave të njeriut
3. Vullnetarizmi rinor
4. Teknologjia e informacionit dhe interneti
5. Lëvizja e lirë në hapësirën europiane

HYRJE

STRATEGJIA KOMBËTARE E RINISË

Nisma

Ideja e rishikimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë (SKR) 2003 lindi si rezultat i nevojës së përputhjes me p[rrpar[sit] e qeverisë së re dhe ndryshimeve social-politike të ndodhura vitet e fundit. Të rinjtë në të gjithë Shqipërinë janë një burim i madh i zhvillimit njerëzor dhe njëkohësisht, një nga agentët kyç për ndryshim social, ekonomik dhe teknologjik.

Format në të cilat sfidat dhe potencialet e të rinjve janë adresuar nga politikat, ndikojnë në kushtet sociale, ekonomike dhe ato të mirëqenies e jetëgjatësisë së brezave që do të vijnë. Të rinjtë dhe të rejtat në të gjithë vendin aspirojnë pjesëmarrje të plotë në jetën shoqërore.

Krijimi i një strategjie gjithëpërfshirëse në shërbim të rinisë dhe hartimi i Planit Kombëtar të Veprimit në fushën e rinisë (2007-2013) është p[rrpar[si e punës së Drejtorisë së Koordinimit të Politikave Rinore në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Parë në dritën e zhvillimeve të reja ekonomike e sociale, ky është një program, i cili synon krijimin e një mjedisi mundësues që siguron pjesëmarrjen e të rinjve në formulimin e politikave dhe procesin e vendimmarrjes në nivel kombëtar.

Duke qenë një prej pasurive më të mëdha të Shqipërisë (afro 70% e popullsisë është nën moshën 30 vjeç), me anë të kësaj strategjie synohet që rinia të ndërgjegjësohet për rolin e vet në ndërtimin e shoqërisë, në sferën e kulturës, si edhe në sferat social-ekonomike. Rinia duhet të shihet me syrin e partnerit të vërtetë e të denjë në këtë qeverisje, duke i dhënë asaj përgjegjësi të drejtpërdrejtë në zhvillimet e sotme në vend.

Politikat rinore-qeveritare

Politikat rinore të Qeverisë Shqiptare vënë në qendër të tyre hartimin e këtyre politikave ndërsektoriale, të gjithanshme dhe me vizione afatgjata. Këto politika bazohen në udhëzimet përkatëse të vendosura në **“Programin botëror të veprimit për rininë nga viti 2002 e më tej”** të Kombeve të Bashkuara dhe në **“White Paper Policy”** të Këshillit të Europës.

Qeveria Shqiptare nëpërmjet kësaj strategjie paraqet politika rinore kombëtare integruese, duke ua adresuar këtë të rinjve dhe çështjeve të lidhura me ta. Kjo do të realizohet si pjesë e një procesi të vazhdueshëm të rishikimit dhe vlerësimit të situatës së të rinjve, zbatimit të programit

rinor kombëtar veprimi ndërsektorial në terma specifike të objektivave të përcaktuara në kohë, si edhe një vlerësimi sistematik të arritjeve të kryera dhe vështirësive të hasura.

Bashkëpunimi me OJF-të rinore është një nevojë e domosdoshme për përmirësimin e rolit të tyre dhe për të arritur në rezultate konkrete në fushën e rinisë.

Në tetor 2005, me fillimin e mandatit të ri qeverisës, Ministri i ri i Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Bujar Leskaj, i dha rëndësi të veçantë hartimit të një SKR-je dhe PKV-je në përputhje me:

1. programin e Qeverisë Shqiptare, si dhe Paktin e Stabilitetit që ka një rëndësi të veçantë për reformat në të gjithë sektorët në vend;
2. programet dhe projektet rinore të vendeve të Europës, duke u përqendruar në strategjitë parësore të zhvillimit, përshtatur sa më afër realitetit të rinisë shqiptare;
3. detyrimet e dala nga Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, si dhe me rekomandimet dhe zhvillimet bashkëkohore të Forumit Rinor Europian;
4. urdhrin e Kryeministrit nr.134 “Për përgatitjen e strategjisë kombëtare për zhvillim dhe integrim”.

Marrëveshje me ministrinë e linjës.

Rishikimi i kësaj strategjie u realizua nga grupi i punës së ekspertëve në fushën e rinisë, të cilët kanë dhënë ide dhe propozime të dobishme për çështjet që trajton kjo Strategji, si dhe nga grupi i punës i ngritur me përfaqësues të ministrive të linjës, të cilët kanë rënë dakord me veprimtarinë e përbashkëta të përfshira në Planin Kombëtar të Veprimit 2007-2013.

GRUPI I EKSPERTËVE

Procesi këshillimor

Drejtorja e Bashkërendimit të Politikave Rinore në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve bashkërendoi procesin e rishikimit të Strategjisë së Rinisë.

Partnerët – Shqipëri, Qendra për Ndryshim dhe Menaxhim Konflikti, fasilitoi procesin e rishikimit të Strategjisë Kombëtare të Rinisë.

Si pjesë të rëndësishme të këtij procesi përmendim ndihmesat:

- e përfaqësuesve të OJF-ve rinore dhe të OJF-ve që kanë në fokus të rinjtë: (*Këshilli Rinor Shqiptar, Parlamenti Rinor, Rrjeti i Studentëve Shqiptarë në Botë* [AS@N](#), *Aksion Plus, Aleanca Gjinore për Zhvillim,*

Qendra Shqiptare për të Drejtat e Fëmijëve, Shoqata Shqiptare e Kombeve të Bashkuara);

- e ekspertëve të agjencive të UN në Shqipëri (UNICEF, UNFPA, UNDP, ILO/IPEC);
- e ekspertëve të fushave të ndryshme akademike;
- e ekspertëve të ministrive të linjës.

Nëpërmjet kësaj strategjie synohet të realizohet plotësimi i angazhimeve të Qeverisë Shqiptare ndaj kërkesave të institucioneve ndërkombëtare të cilat mbulojnë zhvillimin social, kulturor dhe ekonomik të rinisë, duke bërë të mundur fillimin e zgjidhjes së kërkesave të rinisë shqiptare.

Kjo strategji do të rrisë angazhimin për bashkëpunim të të gjithë aktorëve që mbulojnë zhvillimin social-kulturor dhe ekonomik të rinisë shqiptare si: Qeveria Shqiptare, bashkitë dhe komunat, komuniteti i biznesit, institucionet ndërkombëtare shtetërore etj.

Politikat e SKR-së përfaqësojnë gjithë spektrin e pjesëmarrjes rinore në zhvillimin social-kulturor dhe ekonomik të të gjithë shoqërisë, duke u fokusuar në problemet më përparësore.

STRUKTURA

Formulimi i politikave rinore në të gjitha shtetet, vë theksin në qenien e këtyre politikave: **ndërsektoriale**, të gjithanshme, me vizion afatgjatë, të shoqëruar me plane veprimi, duke marrë parasysh këtu:

Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, të nenit 100 të kësaj Marrëveshjeje, për krijimin e një Programi Veprimi të Komunitetit Europian “Për të Rinjtë”, si dhe Librin e Bardhë të Komisionit Europian, të datës 21 nëntor 2001, me titull “Një nxitje për rininë europiane”, si dhe udhëzimet përkatëse të vendosura nga institucionet ndërkombëtare të rinisë të Kombeve të Bashkuara dhe të Këshillit të Europës dhe kryesisht në dy dokumente kryesore, përkatësisht “World Programme of Action for Youth to the Year 2002 and Beyond” (UN) dhe “White Paper Policy” (CoE).ion.

Hartimi i objektivave të kësaj strategjie është mbështetur edhe në instrumentin mbështetës të politikave për rininë, programi me titull “Rinia në veprim” për periudhën 2007-2013, i miratuar me vendimin e Këshillit të Bashkimit Europian dhe Parlamentit Europian nr. 152, datë 14.07.2004, i hapur edhe për vendin tonë.

Qeveria Shqiptare nxitet të hartojë dhe adaptojë një politikë rinore kombëtare integruese, duke iu drejtuar të rinjve dhe çështjeve lidhur me dhe vlerësimit të situatës së të rinjve ta. Kjo duhet realizuar si pjesë e një procesi të vazhdueshëm, e rishikimit, e zbatimit të një Programi Rinor Kombëtar, Aksioni **ndërsektorial**, në terma specifike, e objektivave të përcaktuar në kohë dhe e një vlerësimi sistematik të arritjeve të bëra dhe e vështirësive të hasura. Në këtë kuptim koncepti ndërsektorial synon përshirjen, bashkëpunimin dhe bashkërendimin nëpërmjet pushtetit qëndror dhe vendor, organizatave të pavarura të shoqërisë civile dhe komunitetit të biznesit.

Forcimi i zhvillimit të veprimtarive rinore dhe të çështjeve lidhur me rininë mund të lehtësohet përmes ekzistencës së mekanizmave në të gjitha nivelet për këshillim, shpërndarje informacioni, bashkërendim, monitorim dhe vlerësim. Këto nga natyra mund të jenë ndërsektoriale, mund të kenë drejtim multidisiplinar dhe duhet të përfshijnë pjesëmarrjen e të rinjve, departamentet dhe ministritë përkatëse, organizatat rinore jofitimprurëse kombëtare dhe sektorin privat.

Përpjekje të veçanta dhe të vazhdueshme mund të kërkojnë zhvillimin dhe përhapjen e një kuadri model për integrimin e politikave rinore dhe për identifikimin dhe organizimin e një ndarjeje të përshtashme të përgjegjësive mes strukturave qeveritare dhe joqeveritare lidhur me çështje të rinisë. Përpjekje të veçanta dhe të vazhdueshme duhet të ketë, gjithashtu, edhe në drejtim të forcimit të kapaciteteve kombëtare për

mbledhje të dhënash dhe shpërndarje informacioni, kërkime dhe studime politikash, planifikim, implementim, bashkërendim dhe shërbime këshilluese.

Duhet forcuar veçanërisht mekanizmat e bashkërendimit kombëtar për integrimin e politikave dhe programeve rinore. Qeveria Shqiptare nxitet të promovojë vendosjen e tyre në të gjitha nivelet dhe mbi baza ndërsektoriale.

KUSHTET AKTUALE

Hyrja çdo seksioni jep një skicë të situatës aktuale, duke evidentuar problematikat e ndryshme që prekin të rinjtë dhe fushat, të cilat mund të përmirësohen. Krahas trajtimit të rolit të Qeverisë në sektorin e rinisë, diskutimi i kushteve aktuale, gjithashtu, përfshin edhe trajtimin e angazhimit të organizatave jofitimprurëse dhe sektorit privat.

Më konkretisht ky seksion shqyrton në vija të përgjithshme jo vetëm performancën e shpenzimeve publike, por edhe ndihmesën e aktorëve të ndryshëm të shoqërisë civile dhe komunitetit të biznesit. Kështu synohet të ofrohet një pamje sa më e plotë e konfigurimit të të gjitha palëve të implikuara në zhvillimin shumëpërmasor të rinisë.

Për paraqitjen sa më konkrete të çështjeve kryesore të sektorit, analiza e kontekstit aktual bazohet në një sërë burimesh informacioni dhe të dhënash statistikore, si dhe në studime për sektorin e rinisë nga autorë shqiptarë dhe të huaj. Natyra komplekse e çështjeve të ngritura imponon një përjasje historike ndaj realiteteve bashkëkohore, ku vend të veçantë zë analiza e proceseve transformuese të tranzicionit pas vitit 1990 në vend dhe zhvillimeve rajonale dhe globale gjatë kësaj periudhe. Vëmendje e veçantë i është kushtuar trajtimit të efekteve të tranzicionit politik, ndryshimeve të thella socio-ekonomike, si edhe hapjes kulturore të Shqipërisë ndaj botës së jashtme të rinjtë, të cilët përbëjnë komponentin më të madh demografik në vend.

VIZIONI, PËRPARËSITË DHE QËLLIMET STRATEGJIKE

Strategjia Kombëtare e Rinisë frymëzohet nga vizioni europian mbi angazhimin qytetar, forcimin ekonomik, mbrojtjen sociale dhe zhvillimin kulturor të të rinjve shqiptarë. Përparësitë e angazhimit strategjik i referohen programit të Qeverisë 2005 -2009 me qëllim optimalizimin e burimeve në dispozicion nëpërmjet bashkërendimit të punës së institucioneve shtetërore në nivel qendror dhe vendor, si dhe krijimin e sinergjive nëpërmjet bashkëpunimit shumëpalësh mes Qeverisë, shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare dhe komunitetit të biznesit.

Në këtë kontekst ky seksion trajton përmasa të ndryshme të zhvillimit të të rinjve dhe specifikon qëllimet strategjike përkatëse. Dokumenti i Strategjisë synon të parashtojë një shumësi qëllimesh konkrete për problematikat e ngritura, si dhe të detajojë shpërndarjen e përgjegjësive midis hallkave të ndryshme të pushtetit qendror dhe atij vendor. Si angazhime përparësore brenda sektorit të rinisë, qëllimet strategjike janë në rezonancë të plotë me perspektivën europiane të përcaktuar në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit. Ndërkaq, këto qëllime përkufizojnë edhe një përqsasje strategjike në përputhje me Qëllimet e Zhvillimit të Mijëvjeçarit.

Në kuadrin e angazhimit për integrimin europian, qëllimet e Strategjisë synojnë në zhvillimin e një rinie të kulturuar dhe të shëndetshme që mund të luajë një rol aktiv në demokratizimin dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Në veçanti, pjesëmarrja e rinisë në jetën publike dhe forcimi i statusit të saj socio-ekonomik përbëjnë një domosdoshmëri për zhvillimin e një shteti ligjor konform standardeve europiane dhe një ekonomie tregu të aftë për t'u përballur me sfidat e globalizimit.

POLITIKAT

Ky seksion përbën zemrën e strategjisë sektoriale dhe paraqet karakteristikat kryesore, të cilat do të ndihmojnë në arritjen e qëllimeve në përputhje me vizionin, përparësitë dhe qëllimet strategjike. Në veçanti, analiza e parashtruar do të identifikojë mënyrën se si këto politika janë më efektive se politika alternative për ta çuar sektorin nga situata e tanishme, aty ku duhet të jetë. Theks i veçantë i është vendosur jo vetëm mbulimit të gjithë sektorit, por edhe përkufizimit të politikave, të cilat u japin zgjidhje çështjeve që lidhen me strategjitë ndërsektoriale.

Politikat e specifikuar për secilin nga përmasat strategjike janë të bazuara në punën kërkimore të ekspertëve të angazhuar në përpilimin e Strategjisë mbi efektivitetin e angazhimeve të mëparshme si të instancave shtetërore, ashtu edhe aktorëve të shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare, të cilat operojnë në vend.

Këto politika u referohen edhe përvojave të suksesshme të vendeve në Ballkan dhe Europën Lindore dhe Qendrore, të cilat ndajnë histori të ngjashme me Shqipërinë, si dhe të përvojës së shkëlqyeshme të vendeve të Bashkimit Europian.

LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZA VLERËSUESE

Pjesa e fundit e çdo seksioni parashtron treguesit e monitorimit, të cilët do të lejojnë vlerësimin e ecurisë së përmbushjes të përparësive dhe

qëllimeve strategjike. Gjithashtu, nëpërmjet evidentimit të treguesve të matshëm lehtësohet përgatitja e analizave vlerësuese, si dhe llogaridhënia e nevojshme për mbarëvajtjen e angazhimeve të përbashkëta.

Shumëllojshmëria e indikatorëve tregon qartazi se projektet dhe programet në kuadrin e strategjisë janë të një natyre shumëdrejtimshe dhe ndërdisiplinore. Treguesit e përdorur variojnë nga numri i të rinjve që përdorin internetin, në përfshirjen e zhvillimit të qëndrueshëm në programet e ciklit të mesëm arsimor, në krijimin e Njësive të Informacionit për të Rinjtë, për të lëhtësuar punësimin rinor. Përjasja në këtë seksion është përcaktimi i një matrice vlerësuese, për të monitoruar nëpërmjet treguesve të matshëm efektin konkret të angazhimeve të ndërmarra strategjike.

Në këtë kontekst është e rëndësishme të theksohet se evidentimi i indikatorëve merr parasysh situatën aktuale, e cila karakterizohet nga një mungesë e theksuar e të dhënave statistikore për rininë. Në veçanti kjo nënkupton se në planin afatshkurtër është i pamundur vlerësimi krahasues i projekteve dhe programeve të ndryshme. Monitorimi i rezultateve të arritshme nëpërmjet treguesve të matshëm do të mund të realizohet vetëm në planin afatmesëm dhe afatgjatë. Në këtë kontekst, Strategjia paraqet një listë treguesish dhe skicon planet për mbledhjen e të dhënave në bashkëpunim me INSTAT-in.

Në të vërtetë, dokumenti i Strategjisë përcakton si përparësor grumbullimin e informacionit dhe përpunimin e statistikave ekzistuese për krijimin e një baze të dhënash për rininë shqiptare.

II. PËRFAQËSIMI DHE PJESËRMARRJA RINORE

1. Të rinjtë në jetën publike
2. Zhvillimi i kapaciteteve të organizatave rinore
3. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar
4. Pjesëmarrja e të rinjve në votime

KUSHTET AKTUALE

Të rinjtë në jetën publike

Shqipëria është një nga vendet me përqindjen më të lartë të të rinjve në raport popullsisë, por pavarësisht nga kjo, të rinjtë nuk janë ende pjesë e konsiderueshme e vendimmarrjes. Pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje ende vazhdon të jetë një çështje e predispozitës vetjake të titullarëve të institucioneve dhe jo detyrim ligjor ose administrativ për ta, duke bërë që herë të merret mendimi i të rinjve dhe herë të nënvlerësohet krejtësisht.

Problem kanë qenë edhe mangësitë në përfshirjen e perspektivës gjinore në programe dhe projekte të zhvillimit rinor, të cilat marrin parasysh që vajzat dhe djemtë kanë nevojë dhe akses të ndryshëm ndaj burimeve në sferën shoqërore dhe publike. Kështu, mospjesëmarrja e të rinjve (djem dhe vajza) në vendimmarrje dhe në jetën publike është jo vetëm indikator i një demokracie fiktive, por sjell pasoja të konsiderueshme në jetën publike. Jo rrallë herë merren vendime për të rinjtë pa u marrë mendimi i tyre, çka mund të çojë në kundërshti nga kjo grupmoshë për vënien në jetë të këtyre vendimeve, duke bërë që reformat të mbeten në nivelin teorik pa sjellë pasoja reale.

Disa nga arsyet, që kanë çuar në nivelet e ulta të pjesëmarrjes rinore në vendimmarrje, janë mungesa e bazës ligjore që përcakton detyrimet përkatëse për pjesëmarrjen e të rinjve në vendimmarrje, mungesa e politikave të qarta dhe funksionale nga ana e qeverisë për rritur përfshirjen e të rinjve në jetën publike dhe vendimmarrje, nënvlerësimi që i bëhet kësaj grupmoshe nga pushtetarët. Këtyre faktorëve u bashkëngjitet edhe mosfunksionimi i mirë i strukturave përfaqësuese rinore, të cilat shpesh çojnë në disbalancim gjinor, duke favorizuar pjesëmarrje më të madhe për djemtë.

Zhvillimi i kapaciteteve të organizatave rinore

OJF-të rinore kanë një nevojë të madhe për mbështetje në ndërtimin dhe forcimin e kapaciteteve rinore. Karakteristikë e vetë sektorit rinor është përkohshmëria e lidërshiptit dhe anëtarësisë si pasojë e zhvillimit moshor. Një gjeneratë vjen, një tjetër ikën, por ndryshe nga tradita në vendet e zhvilluara, një pjesë e madhe e OJF-ve rinore (duke vuajtur simptomat e vetë sektorit të OJF-ve në Shqipëri) funksionojnë aktivisht për aq kohë sa lidërshipti themelues është i angazhuar, gjendje përkohshmërie kjo, e cila kompensohet nga një numër i ri organizatash të reja që krijohen nga të tjerë të rinj. Kjo ndërkohë sjell një nevojë të vazhdueshme të ndërtimit dhe forcimit të kapaciteteve në mënyrë periodike të lidërshiptit, stafit, aktivistëve dhe vullnetarëve.

Një problem tjetër karakteristik i sektorit të OJF-ve rinore është mungesa e shpërndarjes së informacionit, në nivel OJF-je, donatorësh, institucionesh. Megjithëse të rinjtë janë pionierë të përdorimit të teknologjive të informacionit, ato pak përdoren si një burim i qëndrueshëm i shpërndarjes së informacioneve të dobishme që nxisin aktivizmin rinor dhe veprimtaritë rinore. Po ashtu, bashkëpunimi midis gjithë strukturave të OJF-ve rinore, institucioneve shtetërore dhe atyre ndërkombëtare ka qenë i fragmentarizuar, sporadik dhe bazuar kryesisht në vullnete individuale.

Një nga problemet më tipike të sektorit të OJF-ve rinore ka qenë edhe mungesa e njohurive dhe aftësive të duhura në drejtim të marrëdhënieve publike (PR). Aftësia për marrëdhënie publike është një fushë ku duhet investuar realisht. Ndërkohë, çështje tjetër e mungesës së kapaciteteve të sektorit të OJF-ve rinore është mosnjohja dhe mospërshtatja e tyre nga filozofitë dhe strategjitë e donatorëve shtetërorë dhe ndërkombëtarë. Nisur nga përkohshmëria, por edhe nga burimet e pakta financiare, OJF-të rinore nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për menaxhim të burimeve në bazë të standardeve dhe praktikave më të mira dhe të kërkuara nga donatorët.

Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar

Me hapjen e Shqipërisë ndaj botës së jashtme pas rënies së sistemit totalitar komunist, periudha e tranzicionit demokratik është karakterizuar nga dukuria e emigracionit masiv drejt vendeve të zhvilluara perëndimore dhe proceset e integritit në ekonominë botërore dhe në struktura dhe organizma ndërkombëtarë. Imazhi negativ, që vendi krijoi në opinionin ndërkombëtar si pasojë e veçorive të valës së parë të emigrantëve dhe zhvillimit të kimit të organizuar, përbën një nga përmasat më problematike të procesit të vështirë të tranzicionit. Kriza

ballkanike dhe konflikti ndëretnik gjatë viteve 1990 konsoliduan skepticizmin dhe frikën e vendeve europiane të cilat reagues, duke izoluar vendet e rajonit nëpërmjet ngritjes së një muri të ri të vizave Schengen, fill pas shembjes së murit të Berlinit.

Megjithatë, viti 2000 shënon një moment të rëndësishëm për zhvillimin e Shqipërisë dhe të vendeve fqinje si pasojë e stabilizimit të situatës në rajon dhe të përparimit drejt zhvillimit të standardeve politike demokratike dhe ekonomive funksionale të tregut të lirë. Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar përbën një aspekt tejet pozitiv për zhvillimin e paqes së qëndrueshme dhe progresit politik dhe social-ekonomik. Në veçanti, bashkëpunimet nga qeveritë e vendeve në rajon dhe aktorëve nga shoqëria civile kanë luajtur një rol kyç në intensifikimin e proceseve të integritit rajonal dhe atij europian.

Në këtë kontekst, ndikim pozitiv në zhvillimet në vend kanë pasur pjesëmarrja dhe angazhimi i të rinjve shqiptarë dhe i organizatave jo-fitimprurëse rinore në veprimtari dhe projekte në nivel rajonal dhe ndërkombëtar. Në veçanti, të rinjtë e angazhuar në këto bashkëpunime kanë luajtur rolin e ambasadorëve të kulturës shqiptare, duke promovuar një imazh pozitiv të Shqipërisë në botë. Gjithashtu, ata kanë sjellë me vete përvojat e vendeve të tjera dhe botëkuptime të reja, duke ofruar kështu një ndihmesë të çmueshme në procesin e zhvillimit të vendit.

Ndërkohë që të rinjtë shqiptarë kanë patur një përfaqësim të gjerë në nismat rajonale dhe ndërkombëtare, ende ka mjaft për të bërë, si nga institucionet qeveritare, ashtu edhe nga shoqëria civile, për të rritur mundësitë e pjesëmarrjes së të rinjve në të tilla bashkëpunime. Çështje me rëndësi të veçantë mbetet liberalizimi i regjimit të vizave në rajon dhe më gjerë në zonën Schengen, në mënyrë që pjesa më e madhe e të rinjve, të cilët aktualisht mbeten të marginalizuar, të mund të gëzojnë lirinë e lëvizjes. Gjithashtu, mbetet ende shumë punë për të bërë në drejtim të forcimit të bashkëpunimeve dhe programeve të shkëmbimeve kulturore, si dhe të përdorimit të teknologjisë së informacionit për shpërndarjen e informacionit për veprimtari dhe projekte rajonale dhe ndërkombëtare.

Pjesëmarrja e të rinjve në votime

Ardhja e demokracisë në Shqipëri solli votën e lirë dhe bashkë me të edhe të drejtën për të abstenuar, një e drejtë kjo që është shfrytëzuar gjerësisht nga të rinjtë shqiptarë në zgjedhjet e zhvilluara gjatë viteve të paskomunizmit.

Disa nga arsyet që i mbajnë të rinjtë larg kutisë së votimit, përveç inercisë, janë lënia pas dore e të rinjve nga politikanët ose dhe zhgënjimi i tyre nga politika. Paqëndrueshmëria politike, si dhe ngjarje të ndryshme

kanë bërë të humbasë besimi i të rinjve te politikanët shqiptarë, por edhe te politika në përgjithësi. Ky zhgënjim vjen edhe si pasojë e faktit se politikanët shpesh nuk i kanë kushtuar ndonjë vëmendje të veçantë të rinjve si një grup interesi për t'u konsideruar në një marrëdhënie ofertë-kërkesë. Përveç kësaj, shpesh të rinjtë janë keqpërdorur gjatë fushatave zgjedhore, duke shërbyer vetëm si një fasadë. Për këtë arsye shumë të rinj prej vitesh i qëndrojnë larg kutisë së votimit.

Po t'i referohemi studimeve të bëra mbi pjesëmarrjen në votime, do të vëmë re se grupmosha që nuk voton përbëhet kryesisht nga të rinjtë (35 vjeç e poshtë). Ky fakt na tregon se mospjesëmarrja e të rinjve në votime është një proces që e ka zanafillën rreth 15 vjet më parë (në vitet 90-91) dhe ka ardhur duke u thelluar si problem.

Duke qenë se kësaj dukurie nuk i është kushtuar vëmendja e nevojshme, grupmosha që nuk merr pjesë në votime, për shkak të incerisë, por edhe të mungesës së kulturës së votës, ka ardhur duke u rritur, duke rrezikuar që në të ardhmen të kemi familje të tëra që nuk marrin pjesë në votime. Një dukuri e tillë do të bënte që shoqëria jonë të qeverisej nga zgjedhja e pakicës, duke dëmtuar rëndë sistemin e demokracisë përfaqësuese.

VIZIONI, PËRPARËSITË DHE QËLLIMET STRATEGJIKE

Të rinjtë në jetën publike

Pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje është e rëndësishme jo vetëm për të respektuar vendin që ata zënë dhe rolin që luajnë në një shoqëri demokratike, por edhe për risitë që ata sjellin në mënyrën e të konceptuarit, si dhe për lehtësinë me të cilën përqafojnë integrimin.

Qëllim përparësor përbën mbarëvajtja e proceseve integruese të hartimit dhe zbatimit të politikave rinore me synim investimin në krijimin e drejtuesve të së ardhmes, të cilët do të jenë njohës më të mirë të politikave, administratës dhe funksionimit të demokracisë. Ndërkohë theks i veçantë i duhet dhënë faktit se pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje dhe në jetën publike i bën ata më të interesuar në llogaridhënien e Qeverisë, duke kontribuar kështu në zhvillimin e demokracisë.

Gjithashtu, pjesëmarrja e të rinjve sjell evidentimin e problemeve më afër realitetit të vetë të rinjve, meqenësë ata kanë një njohje më të mirë të situatës dhe perspektiva konkrete më pranë nevojave të grupmoshës së tyre dhe komunitetit ku jetojnë. Në këtë drejtim, rëndësi të veçantë ka angazhimi me pjesëmarrje të barabartë nga të dyja gjinitë, me qëllim që vendimet e marra të jenë sa më përfaqësuese. Qëllim strategjik përbën

përvetësimi i modeleve perëndimore të përshtatshme përsa i përket pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje, si dhe të përshtaten skemat e aplikuara, duke marrë parasysh realitetin shqiptar.

Zhvillimi i kapaciteteve të organizatave rinore

Vizioni i Strategjisë në drejtim të ndërtimit dhe forcimit të kapaciteteve të organizatave rinore fokusohet në nevojën për investim të burimeve teknike dhe financiare për informimin, trajnimin dhe monitorimin e organizatave – me synim krijimin e mundësive efektive për shkëmbime të ndërsjella informacioni dhe përvojash, si dhe për bashkëpunime për projekte dhe programe të posaçme.

Përparësi përbën përmirësimi i strukturave të sektorit rinor të shoqërisë civile në nivel institucional, ekzekutiv dhe gjeografik. Qëllime strategjike përbëjnë ndërtimi dhe forcimi i shoqërisë civile, rritja e kapaciteteve dhe e efektivitetit organizativ, si dhe rritja e interesit për bashkëpunim nga institucione dhe organizata ndërkombëtare. Ndërkohë rritja e nivelit të bashkëpunimit mes organizatave rinore përbën një domosdoshmëri në forcimin e rolit të tyre në përmirësimin e jetës së të rinjve dhe të mjedisit të tyre kulturor dhe socio-ekonomik.

Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar

Mbështetja aktive nga institucionet qeveritare për pjesëmarrjen e të rinjve shqiptarë dhe organizatave joqeveritare rinore në veprimtari rajonale dhe ndërkombëtare përbën një element thelbësor të vizionit strategjik për integrimin e vendit në nivel rajonal dhe në veçanti për integrimin në Bashkimin Europian. Pjesëmarrja në bashkëpunime dhe shkëmbime ndërkombëtare luan një rol shumë të rëndësishëm në forcimin e një imazhi pozitiv të Shqipërisë, siguron përfaqësimin e drejtpërdrejtë të qëndrimeve dhe interesave të rinisë shqiptare, promovon fuqizimin e të rinjve dhe strukturave të tyre organizative, si dhe krijon mundësinë për marrjen e përvojës së vlefshme të vendeve të tjera. Zhvillimi i veprimtarive dhe nismave kulturore në rajon kanë rëndësi të veçantë për zhvillimin e fqinjësisë së mirë, kapërcimin e të shkuarës konfliktuale, si dhe ndërtimin e një të ardhmeje të përbashkët si pjesë e familjes Europiane

Një përmasë tjetër strategjike në nivelin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar është dhe bashkërendimi midis organizatave joqeveritare rinore dhe ministrive përkatëse të rinisë në hartimin, implementimin, monitorimin dhe vlerësimin e programeve rinore rajonale dhe projekteve ndërkombëtare. Ndërkaq, forcimi i bashkëpunimit me strukturat ndërkombëtare të rinisë do të ndihmojë në zhvillimin e dialogut mbi politikat ekzistuese, në mënyrë që ato t'i përgjigjen prirjeve të rinisë dhe proceseve të globalizimit ekonomik, politik, dhe kulturor.

Në këtë kontekst duhet theksuar se një nga mënyrat më të frytshme për mbështetjen e pjesëmarrjes së të rinjve shqiptarë në bashkëpunime dhe nisma ndërkombëtare është përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe telekomunikacionit. Ndërtimi i një portali *online* me informacion për veprimtaritë, si edhe mundësitë për mbështetje financiare do të kontribuojë në mënyrë të ndjeshme në rritjen e përfaqësimit rinor shqiptar në këto veprimtari ndërkombëtare.

Pjesëmarrja e të rinjve në votime

Vizioni i kësaj strategjie është pjesëmarrja masive e të rinjve në votime. Qëllim parësor është hartimi dhe implementimi i politikave informuese dhe edukuese për të rinjtë, duke nxitur pjesëmarrjen e tyre në votime si dhe një qytetari më të përgjegjshme. Edukimi i të rinjve, për të marrë pjesë në procesin zgjedhor, i bën ata të kuptojnë më mirë sistemin qeverisës dhe të jenë më kërkuar ndaj menaxhimit të taksave të tyre.

Pjesëmarrja e tyre në votime ushtron një trusni më të madhe mbi politikanët për politika të reja dhe për standarde europiane. Kjo, pasi të rinjtë, duke mos patur paragjykime partiake apose remenishenca të së kaluarës, janë të gatshëm të mbështesin ato politika të cilat përmirësojnë mënyrën e tyre të jetesës. Ky pragmatizëm do të sjellë edhe interesim më të lartë të politikanëve për të rinjtë, duke zgjuar në këtë mënyrë edhe interesin e të rinjve për të marrë pjesë në votime. Të rinj aktiv gjatë zgjedhjeve do të thotë të rinj aktiv edhe gjatë periudhës midis dy mandateve, çka do të sjellë në Shqipëri kulturën e trusnisë ndaj përfaqësuesve të popullit, për të kryer më së miri misionin e tyre të përfaqësimit.

Mbështetja e strukturave të përfaqësimit rinor, të cilat ngrihen në bazë votimi nga të rinjtë, është një objektivi i rëndësishëm për të edukuar te të rinjtë demokracinë, votimin dhe rëndësinë e pjesëmarrjes në votime. Në këtë mënyrë hedhim bazat e së ardhmes nëpërmjet edukimit të të rinjve si qytetarë të përgjegjshëm, me të drejtën dhe përgjegjësinë e votës.

Qëllim strategjik është sjellja e përvojave të tjera botërore për përfshirjen e të rinjve në votime, si dhe për angazhimin e tyre në procesin e monitorimit të zgjedhjeve. Angazhimi i të rinjve, për të monitoruar në mënyrë vullnetare zgjedhjet, i bën ata më të përgjegjshëm për votën dhe më të interesuar për të marrë pjesë në votime, duke qënë më aktiv dhe duke ndikuar te grupet e tyre shoqërore për pjesëmarrje më të gjerë në votime. Në këtë mënyrë të rinjtë do të jenë zgjedhës aktiv, si dhe agjentë të ndryshimit.

POLITIKAT

Të rinjtë në jetën publike

- Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe pushtetin vendor, duhet të krijojë mundësi, nëpërmjet ngritjes së infrastrukturës së nevojshme, për zhvillimin e strukturave përfaqësuese të rinisë në të gjitha nivelet. Gjithashtu, të mbështesë në mënyrë të vazhdueshme financiare ecurinë dhe fuqizimin e strukturave përfaqësuese rinore ekzistuese dhe atyre të sapongritura.
- Rishikimi i lëndëve *Edukatë qytetare* dhe *Njohuri për shoqërinë*, nga bashkëpunimi i MASH-it dhe OJF-ve rinore me synim riformulimin e materialit për rolin e të rinjve në jetën publike dhe rëndësinë e pjesëmarrjes rinore në vendimmarrje – duke marrë parasysh ndryshimet në ofrimin e arsimit, mentalitetin mbi arsimimin për djemtë dhe vajzat, zonat gjeografike, ndryshimet në të ardhura, fe, etj.
- Përfshirja e të rinjve në të gjitha bordet vendimarrëse administrative të ngritura për çështje që prekin interesat e kësaj grupmoshe në nivel qendror (ministritë e linjës) si dhe në nivel vendor (bordet qytetare pranë Bashkive dhe Komunave), duke kontribuar në një mirëqeverisje dhe në ndërtimin e një sistemi demokratik.
- Zhvillimi i llogaridhënies së qeverisë përballë të rinjve nëpërmjet zhvillimit të interpelancës së Ministrit të Rinisë dhe Ministrit të Arsimit përballë të rinjve në mënyrë periodike (çdo 6 muaj) me synim zgjimin e interesit të të rinjve mbi politikën e qeverisë dhe krijimin e mundësive për një komunikim më të mirë mes të rinjve dhe qeverisë.
- Ndërgjegjësimi i të rinjve për të marrë pjesë në vendimmarrje, nëpërmjet organizimit të workshop-eve, trajnimeve dhe edukimit të tyre të vazhdueshëm për rëndësinë që ka për zhvillimin e demokracisë në vend pjesëmarrja e tyre në vendimmarrje dhe në jetën publike.

Zhvillimi i kapaciteteve të organizatave rinore

- Trajnimi për lidërsip rinor dhe forcimin e pjesëmarrjes demokratike në vendimmarrje dhe pjesëmarrjes brenda vetë organizatave rinore.
- Nixitja e bashkëpunimit mes organizatave rinore përmes tryezave të rrumbullakëta, mbledhjeve formale dhe joformale, në nivel vendor dhe kombëtar.
- Institucionalizimi i rrugëve të bashkëpunimit të institucioneve shtetërore dhe sidomos pushtetit vendor me shoqërinë civile në përgjithësi dhe ato në sektorin e rinisë në veçanti.
- Ngritja e një rrjeti për shkëmbimin e informacionit dhe përvojave mes të rinjve nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe internetit.

- Angazhimi i institucioneve shtetërore në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar për bashkërendimin e projekteve dhe të programeve me synim forcimin e kapaciteteve planifikuese dhe bashkërenduese mes OJF-ve rinore.

Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar

- Përdorimi i teknologjisë së informacionit për grumbullimin, përpunimin dhe qarkullimin e informacionit mbi projekte bashkëpunimesh dhe shkëmbimesh rajonale dhe ndërkombëtare, si edhe mundësitë për mbështetje financiare për pjesëmarrje në këto veprimtarie.
- Përfshirja e përfaqësuesve të organizatave jofitimprurëse rinore në delegacionet përfaqësuese të vendit në konferenca ministrash përgjegjës për çështje të rinisë, në nivele rajonale dhe ndërkombëtare.
- Liberalizimi progresiv i regjimit të vizave, për të lehtësuar lëvizjen e lirë të të rinjve në rajon dhe në Bashkimin Europian.
- Promovimi i dialogut ndërkulturor dhe i bashkëpunimit rajonal nëpërmjet programeve të shkëmbimit, organizmit të seminareve dhe workshop-eve edukative etj.

Pjesëmarrja e të rinjve në votime

- Organizimi i procesve 'mock-election' nëpër shkolla të mesme, të larta, si dhe për të rinjtë e komunitetit.
- Organizimi i festave masive *Pop & Vote* dhe *Rock & Vote*.
- Organizimi i fushatave informuese dhe ndërgjegjësuese.
- Organizimi i forumeve të diskutimit me kandidatët për deputet.
- Organizimi i fushatave kombëtare ndërgjegjësuese.
- Organizimi i emsioneve dhe debateve televizive, të cilat trajtojnë nevojën e pjesëmarrjes së të rinjve në votime.
- Ngritja dhe fuqizimi i website-ve zgjedhore informuese dhe orientuese për të rinjtë.
- Publikimi i botimeve informuese për pjesëmarrjen e të rinjve në votime.
- Bashkëpunim me mediat rinore (*gazetat e shkollave etj.*) për të ndërgjegjësuar të rinjtë për pjesëmarrjen e tyre në votime.
- Favorizimi dhe nxitja e të rinjve që monitorojnë vullnetarisht zgjedhjet.
- Ngritja e infrastrukturës dhe bashkëpunimi me organizata dhe struktura përfaqësimi të të rinjve për angazhimin e sa më shumë vëzhguesve të rinj.

TREGUESIT DHE BURIMET

Të rinjtë në jetën publike

Nëpërmjet kësaj përparësie synohet rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje dhe në jetën publike.

Duke qenë se të rinjtë shqiptarë nuk janë aktivë në jetën publike dhe në vendimmarrje, synojmë që nëpërmjet veprimtarive, programeve dhe trjanimave të ndryshme të përfshijmë të rinjtë në votime, në zhvillimin e kapaciteteve të organizatave rinore, në bashkëpunimin në nivel rajonal dhe ndërkombëtar etj.

Nëpërmjet ndërtimit të rrjeteve kundër korrupsionit do të rritet numri i të rinjve në fushatat ndërgjegjësuese në luftën kundër korrupsionit.

Nëpërmjet programeve të informimit synojmë të përmirësojmë aftësitë e të rinjve, për të marrë informacion për çështje të rëndësishme që ndikojnë teknikisht drejtpërdrejt në nevojat e tyre.

Me anë të veprimtarive të fokusuara në kulturë, ekonomi, turizëm, minoritet, siguri në të gjitha zonat e vendit, do të rritet niveli i bashkëpunimit dhe do të integrohen të rinjtë në rajon e më gjerë.

Këto veprimtari do të zhvillohen në bashkëpunim me OJF-të rinore, ministritë e linjës etj.

Me synim rregullimin me ligj të pjesëmarrjes së të rinjve në borde drejtuese, këshilla, komisione etj., në shkolla të mesme, universitete e bashki, pjesëmarrja e të rinjve në bordet e shkollave do të rritet me 20%.

Zhvillimi i kapaciteteve të organizatave rinore

Nëpërmjet programeve të trajnimit për lidërsipin rinor, shkëmbim informacioni dhe bashkërendimi i shumë veprimtarive të organizatave dhe strukturave përfaqësuese rinore do të rrisim zhvillimin e kapaciteteve të OJF-ve rinore dhe strukturave rinore.

Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar

Nëpërmjet veprimtarive, që promovojnë bashkëjetesën dhe sigurinë në rajon e më gjerë, do të rritet bashkëpunimin e të rinjve rajonal dhe ndërkombëtarë.

Deri tani bashkëpunimi në rajon dhe më gjerë ka qenë në përqindje minimale. Nga periudha 2007-2011, me programe dhe veprimtari, sidomos me pjesëmarrje në arenën ndërkombëtare do të synohet të rritet bashkëpunimin për të mirën e të rinjve dhe vendit.

Pjesëmarrja e të rinjve në votime

Nëpërmjet fushatave sensibilizuese mediatike dhe veprimtarive, të cilat do të ndërgjësojnë të rinjtë se sa të rëndësishëm janë ata në procesin e

votimit, synohet rritja e përqindjes së të rinjve që votojnë nga 45%, në shifra me të larta.

III. Të RINJTË DHE EKONOMIA

1. Punësimi i të rinjve
2. Thithja e trurit: Të rinjtë që studiojnë jashtë vendit
3. Biznesi rinor dhe vetëpunësimi
4. Formimi profesional i të rinjve
5. Aftësimi si konsumatorë i të rinjve

KUSHTET AKTUALE

Punësimi i të rinjve

Krijimi i mundësive të punësimit dhe punësimi i të rinjve janë një nga përparësitë e çdo qeverie. Megjithatë ekziston një diferencë midis qëllimeve të mira politike dhe asaj që ndodh në realitet. Të rinjtë në Shqipëri kanë më shumë mundësi të punësohen sesa moshat më të vjetra. Ka një pabarazi të theksuar midis të rinjve të punësuar në poste drejtuese dhe atyre në nivelet më të ulta. Për shkak edhe të ndryshimit të sistemeve, të rinjtë janë më të aftësuar dhe të përshtatur për t'u integruar në tregun e punës. Përsëri mundësitë e punësimit që iu ofrohen nuk përfaqësojnë pritshmëritë që kanë të rinjtë nga tregu i punës.

Fëmijët dhe të rinjtë në Shqipëri përbëjnë më shumë se gjysmën e popullsisë dhe përfaqësojnë grupin më të madh të forcës së aftë për punë, si në zonat rurale, ashtu edhe ato urbane. Megjithatë, aftësia dhe forca për punë nuk përbëjnë garanci për gjetjen e një vendi të përshtatshëm pune, kjo edhe për shkak të vendeve të kufizuara për punë. Nga ana tjetër migrimi i brendshëm, ekonomia informale, mungesa e politikave të përshtatshme të nxitjes së punësimit ndërmjet të rinjve dhe moslidhja e arsimit me tregun e punës, krijon një situatë të disfavorshme për punësimit e të rinjve.

Thithja e trurit: të rinjtë që studiojnë jashtë vendit

Një nga përmasat e tjera me problematike të tranzicionit pas 1990-ës është edhe dukuria e largimit të trurit nga Shqipëria me përmasa shqetësuese. Nga disa statistika të *Rrjetit të Studentëve Shqiptarë në Botë (AS@N)*, numri i studentëve që studiojnë jashtë vendit aktualisht vlerësohet të jetë më shumë se 25000. Ndërkohë, nga sondazhe të ndryshme rezulton se përqindja e të rinjve dhe studentëve që janë të sigurt se do të kthehen në vendlindje, luan në shifra shumë të vogla (5 -

10%). Largimi i trurit nuk përfshin vetëm të rinjtë, dhe veçanërisht studentët, por këta konsiderohen një nga pjesët më të rëndësishme të së ardhmes së kombit.

Vërehet me lehtësi se mungesa e politikave reale që synojnë të shfrytëzojnë pasurinë dhe energjinë intelektuale të të rinjve shqiptarë që studiojnë ose punojnë jashtë dhe rënia e interesit të vetë të rinjve shqiptarë për të investuar të ardhmen e tyre në Shqipëri, janë disa nga pengesat më kryesore për rikthimin e trurit. Gjithashtu, nuk është në nivelin e duhur prania e mekanizmave të promovimit të ndjenjës së përkatësisë kombëtare për të rinjtë shqiptarë që studiojnë ose punojnë jashtë, duke anashkaluar faktin se këta të rinj janë ambasadorët e vërtetë dhe imazhi më i mirë i një vendi, i cili kërkon të ecë përpara dhe të zhvillohet në mënyrën e duhur.

Mungesa e deritanishme e infrastrukturës së nevojshme për “*kthimin e trurit*”, mungesa e politikave të vazhdueshme për nxitjen e kthimit të studentëve, mungesa e informacionit rreth institucioneve shtetërore dhe private dhe mundësive të punësimit në to, bëjnë që një pjesë shumë e vogël e të rinjve të diplomuar jashtë vendit dhe të atyre që janë integruar në mjedisin e punës në vendet ku jetojnë, të kthehen për të punuar në Shqipëri dhe për të dhënë ndihmesën e tyre. Në këtë mënyrë, ky potencial shpërndahet dhe humbet pa arritur të japë ndihmesën e përqendruar dhe të përbashkët, me qëllim zhvillimin e vendit me hapa perëndimorë.

Biznesi rinor dhe vetëpunësimi

Zhvillimi i biznesit rinor paraqet një rëndësi të veçantë, si në drejtim të krijimit të vendeve të reja të punës, ashtu edhe në drejtim të zhvillimit të ekonomisë në Shqipëri. Nga ana tjetër, nxitja e krijimit të bizneseve rinore krijon premisa për forcimin e kapaciteteve të të rinjve dhe nxit pavarësinë e të rinjve karshi familjes dhe shtetit.

Mungesa e të dhënave statistikore e bën të vështirë analizën e drejtë të faktorëve që ndikojnë në mospërfshirjen e të rinjve në krijimin e bizneseve të reja. Megjithatë, shumë ekspertë mendojnë se ndër faktorët kryesorë që ndikojnë negativisht në këtë drejtim janë objektive dhe subjektive. Ndër këta faktorë mund të përmendim implikimet e informalitetit ekonomik që dëmton kokurrencën e drejtë dhe vendos bizneset rinore në situatë të disfavorshme, mungesën e nismës ndërmjet të rinjve dhe frika e dështimit, traditat familjare dhe kontrollin që familja vazhdon të ushtrojë mbi jetën e të rinjve.

Gjithashtu, faktorë të tjerë që duhet të merren në konsideratë janë mos njohja e kuadrit ligjor nga të rinjtë, përsa i përket krijimit të një biznesi dhe mjedisit ligjor ku ai zhvillohet, mungesa e njohjes së realitetit

ekonomik dhe atij bankar dhe e nevojave për hapjen e bizneseve të reja, si dhe mungesa e infomacionit të përshtatshëm dhe të aksesueshëm për të rinjtë dhe nga të rinjtë përse i përket sistemit të taksave, marrjes së kredive me norma bankare të ulta, fushave ku mund të investohet, etj.

Në këtë kontekst vlen të theksohet se rol të rëndësishëm ka luajtur edhe mungesa e politikave nxitëse, fiskale dhe ligjore, në nivel të Qeverisë qendrore dhe atyre vendore, çka kufizon mundësitë që të rinjtë të marrin në konsideratë hapjen e një biznesi të ri. Megjithatë, vitet e fundit janë shtuar përpjekjet e Qeverisë dhe të biznesit në tërësi, për të nxitur dhe krijuar mundësi në krijimin e bizneseve të krijuara dhe të drejtuara nga të rinjtë. Sot bizneset rinore luajnë një rol jo të vogël në ekonominë vendore të komuniteteve ku ata jetojnë, por impakti i këtyre bizneseve në nivel kombëtar mbetet ende në vlera të papërfillshme.

Formimi profesional i të rinjve

Ndryshimet politike, ekonomike dhe sociale që kanë ndodhur në vendin tonë në dhjetëvjeçarin e fundit, si rezultat i kalimit nga ekonomia e centralizuar në ekonominë e lirë të tregut, kanë ndikuar dukshëm edhe në fushën e Arsimit dhe të Formimit Profesional (AFP). Transformimet, që sollën lindjen e ekonomisë së tregut, kanë shtruar para shoqërisë nevojën për nivele të reja kualifikimi në drejtim të teknologjive e shërbimeve të reja. Orientimi nga tregu i punës, si dhe nga praktika, së bashku me kërkesën për fleksibilitet, janë tani pika të rëndësishme për zhvillimin e mëtejshëm të AFP-së, për t'i dhënë atij një fytyrë të re dhe për të edukuar dhe pajisur brezat e rinj me kualifikimet dhe shkathtësitë e shprehite (*skills*) e nevojshme që kërkohen sot nga tregu i punës.

Sistemi aktual i Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP) në Shqipëri është i dobët, si nga pikëpamja sasiore, ashtu dhe nga cilësia. Në përgjithësi, ka mungesë të infrastrukturës së përshtatshme, financim të pamjaftueshëm, nivel të ulët të burimeve njerëzore, kurrikula të vjetëruara dhe metodë menaxhimi të tejkaluara.

Në këtë kuadër do të synohet bashkëpunimi me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, ku nëpërmjet një projekti të Drejtorisë së Bashkërendimit të Politikave Rinore do të synohet ngritja e infrastrukturës për formimin profesional. Aktualisht në shkallë vendi funksionojnë 40 shkolla të arsimit teknik e profesional, të shpërndara në 22 rrethe. Nga këto, në zonat rurale funksionojnë 3 shkolla profesionale, me drejtim kryesor bujqësi-agrobiznes. Shkollat janë të ndara në 4 *fusha kryesore*: elektro-mekanike (18 shkolla), ekonomike (9 shkolla), ndërtim-mobileri (4 shkolla); bujqësi, pyje, veterinari (9 shkolla). Nxënësit përgatiten në rreth 35 specialitete kryesore.

Përsa i përket Formimit Profesional (FP), ky operon nëpërmjet 9 qendrave publike të formimit profesional në qytetet më të mëdha të vendit si në Vlorë, Shkodër, Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Tepelenë dhe Fier, si dhe 120 subjekte private të licencuara, nga të cilat 24 janë QJF, me një shtrirje në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Megjithatë, si Arsimi Profesional, ashtu dhe Formimi Profesional vazhdojnë të kenë një reputacion të ulët nga pikëpamja cilësore dhe në to angazhohen një përqindje mjaft e ulët e nxënësve, të rinjve, ose e rriturve. Edhe sektori privat i AFP-së është ende i dobët dhe karakterizohet nga tipare të ngjashme me atë publik.

Aftësimi si konsumatorë i të rinjve

Aftësimi i të rinjve si konsumatorë (*sidomos gjatë periudhës së adoleshencës*) është pjesë integrale e mekanizmave ligjorë, politike dhe teknike të mbrojtjes së konsumatorëve dhe është pjesë e të drejtave bazë për të cilat konsumatorët duhet të fitojnë njohuritë dhe aftësitë, për të vepruar në treg në mënyrë kompetente dhe të informuar.

Por vetë koncepti *konsumator* në realitetin shqiptar nuk është ende shumë i njohur për qytetarët shqiptarë dhe natyrisht edhe për të rinjtë, sepse qytetarët shqiptarë kanë ndërgjegje të ulët konsumatori. Ata nuk janë të vetëdijshëm për atë se çka do të thotë të jesh konsumator. Të drejtat e konsumatorit janë të përfshira në ligjin për mbrojtjen e konsumatorëve, të miratuar në vitin 2003, por vetëm një pakicë e di se cilat janë këto të drejta.

Çështje të përgjithshme të mungesës së kulturës konsumatore janë edhe probleme të të rinjve, si mungesa e vëmendjes ndaj njohjes me cilësitë dhe karakteristikat e produkteve dhe të shërbimeve, mungesa e njohurive për sigurinë e produkteve ose të shërbimeve, vlerësimi i kushteve të tregtimit, mirëmbajtja e produkteve, njohja e kushteve të kontratave, garancive ose përlllogaritja e vlerave financiare etj. Por duke qenë se kultura konsumatore krijohet që në fëmijëri dhe adoleshencë, rëndësia që merr edukimi dhe aftësimi si konsumatorë të zgjuar përbën një çështje me interes të përgjithshëm.

Të rinjtë shqiptarë, nga studime të ndryshme, rezultojnë si konsumatorë të rëndësishëm të produkteve të parekomandueshme si duhani, alkooli, lojërat e fatit, por edhe në shpenzime të rënda për buxhetin e shumicës dërrmuese të familjeve shqiptare nëpër blerjen e veshjeve të shtrenjta, për komunikimin telefonik celular, lojërat elektronike, baret, pub-et, diskotekat, shpenzime të shumta për paraqitjen etj. Sjellja e të rinjve si konsumatorë synon modele të standardeve të larta të jetesës bazuar në kulturën globale, por që nuk i përgjigjen shkallës së standardit të jetesës në Shqipëri.

Ndërkohë që prirja për shpenzime të mëdha nuk i përgjigjet pavarësisht ekonomike të të rinjve, sidomos adoleshentëve dhe studentëve, përpjekjet e tyre ekonomike për arsim, formim profesional ose edhe punësimi sezonal ose *part-time* janë të ulëta.

Tipike është edhe shkalla e ulët e prirjes për kursim, duke krijuar modele jo shumë efektive për nevojat e së ardhmes, ku kreditimi për ndërtimin e një familjeje të re kërkon prirje për një mirëmenaxhim të buxheteve familjare.

VIZIONI, PËRPARËSITË DHE QËLLIMET STRATEGJIKE

Punësimi i të rinjve

Vizioni i Strategjisë Kombëtare të Rinisë synon të caktojë objektiva konkretë për nxitjen e punësimit ndërmjet të rinjve. Ajo duhet parë e lidhur ngushtë edhe me pjesën e strategjisë ku flitet për nxitjen e bizneseve rinore, pasi të dyja së bashku ato përbëjnë elemente thelbësore të forcimit të të rinjve në Shqipëri, nëpërmjet krijimit të mundësive të përshtatshme për të gjithë.

Në këtë kuadër, përparësore do të jetë anagazhimi i Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, që në përgatitjen dhe miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit të përfshijë politika nxitëse punësimi dhe për të rinjtë, duke iu referuar dhe përgatitjes brenda kësaj strategjie të një kreu për punësimin e të rinjve në Shqipëri. si edhe përcaktimin e ndryshimeve dhe shtesave në Kodin e Punës për rregullimin e kohës dhe kushteve të punës, si për punën *part-time*, ashtu edhe për atë me kohë të plotë për të rinjtë në Shqipëri.

Gjithashtu, rol kyç do të luajë Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta për krijimin e programeve të nxitjes së punësimit të të rinjve pranë bizneseve ose OJF-ve; gjithashtu, kjo Ministri duhet të krijojë në çdo rreth të Shqipërisë Njësi të Informacionit për të Rinjtë, të cilat duhet të mbajnë lidhje të ngushta me sektorin e biznesit dhe me të gjitha shkollat në rreth.

Thithja e trurit: të rinjtë që studiojnë jashtë vendit

Vizioni strategjik lidhet me investimin në “kthimin” dhe “qarkullimin” e trurit, në mënyrë që të rinjtë që studiojnë jashtë vendit të mund të kontribuojnë në rigjenerimin e ekonomisë shqiptare dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit drej standardeve europiane, nëpërmjet përvijës së fituar, *know-how* bashkëkohor, shkollimit të nivelit të lartë, kulturës dhe një mënyre globale të menduari dhe etike të lartë pune.

Përparësore në këtë mes do të jenë hartimi dhe implementimi i politikave realiste që synojnë të shfrytëzojnë pasurinë dhe energjinë intelektuale të të rinjve shqiptarë që jetojnë dhe studiojnë jashtë vendit dhe investimi i tyre në Shqipëri ose për Shqipërinë. Në këtë kontekst duhen marrë masa për të shmangur largimin e trurit, duke rritur ofertën për punësim në vend, për të stimuluar kthimin e një kategorie profesionistësh të rinj të nevojshëm në Shqipëri. Gjithashtu, duhen krijuar mundësitë për t'u njohur me realitetin shqiptar në mjedisin e punës dhe për t'i ndihmuar dhe informuar për një zgjedhje jo të lehtë në lidhje me vendin ku të rinjtë synojnë dhe do të investojnë njohuritë e tyre në të ardhmen.

Një drejtim tjetër përparësor do të jetë bashkëpunimi me organizmat përfaqësues të studentëve dhe me institucionet ndërkombëtare të specializuara, për të krijuar dhe lehtësuar komunikimin e studentëve me institucione të ndryshme dhe shkëmbimin i përvojës dhe të informacioneve mes tyre. Rëndësi të madhe ka lehtësimi i procesit të njohjes në Shqipëri të titujve akademikë të fituar jashtë vendit, për të lehtësuar integrimin e tyre në tregun e punës.

Biznesi rinor dhe vetëpunësimi

Vizioni i Strategjisë Kombëtare të Rinisë, përsa i përket bizneseve rinore, merr në konsideratë vizionin e Qeverisë Shqiptare për të rinjtë në Shqipëri. Në të njëjtën kohë ky vizion kërkon të krijojë mundësi, për të rinjtë që duan të hapin një biznes, të gjejnë asistencën dhe hapësirat e nevojshme për të ushtruar këtë të drejtë të tyre. Nga ana tjetër vizioni merr në konsideratë rolin që duhet të luajë Qeveria, si një rregullator i jetës ekonomike në vend, në nxitjen e krijimit të bizneseve të reja dhe fuqizimin e rinisë.

Drejtimi i rëndësishëm strategjik do të jetë përgatitja e një pakete fiskale, mekanizma nxitës dhe lehtësues për të rinjtë, të cilët kërkojnë të hapin biznese të reja ose i kanë hapur ato, duke u dhënë përparësi nismave të të rinjve në zonat rurale dhe grupeve të marginalizuara.

Qeveria duhet të nxisë OJF-të në krijimin e agjencive rinore të informimit ekonomik, fiskal, ligjor dhe të punësimit. Në këtë kontekst, rëndësi të veçantë do të ketë kryerja e studimeve periodike për punësimin e të rinjve në tregun e punës, duke patur edhe fokus të veçantë në ndryshimet midis gjinive. Në fakt, një nga përmasat kryesore të qëllimeve strategjike do të jetë përfshirja e perspektivës gjinore në projektet dhe programet e punësimit.

Një nga përparësitë e tjera do të jetë krijimi i një njësie financimi të projekteve që kanë të bëjnë me krijimin e mikrobizneseve që drejtohen nga të rinjtë, si dhe në veçanti stimulimi i sektorit bujqësor nëpërmjet vetëpunësimit për vajzat që kërkon dhe një akses më të madh ndaj

këtyre burimeve për vajzat. Një rol kyç do të luajë angazhimi i Ministrisë së Financave, për të negociuar me bankat e nivelit të dytë për krijimin e një kredie të veçantë, të quajtur “Biznesi Rinor”, për të rinjtë që duan të hapin një biznes të ri, me kushte dhe interesa favorizuese për të rinjtë.

Formimi profesional i të rinjve

Vizioni strategjik përcakton si të domosdoshëm përfshirjen e AFP-së në rrjedhën e zhvillimeve bashkohore, në harmoni me ato ç’ka po ndodhin në rajon dhe Bashkimin Europian. Qëllimi përfundimtar është harmonizimi i politikave të AFP-së ndërmjet tyre, si dhe me politikat e fushave të tjera, të interesuara për zhvillimin e burimeve njerëzore, ekonomike, sociale, të tregut të punës etj., duke realizuar një përdorim sa më racional të burimeve financiare e njerëzore.

Një nga përparësitë e vizionit strategjik për formimin profesional të të rinjve do të jetë krijimi i një sistemi unik dhe cilësor të AFP-së, i aftë për të kontribuar në zhvillimin e vazhdueshëm të aftësive profesionale dhe qytetarisë aktive të të rinjve dhe të rriturve, nëpërmjet ofrimit të kualifikimeve profesionale, në përputhje me kërkesat e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit, në kuadrin e integritit rajonal dhe europian. Pjesë integrale për punën në këtë drejtim do të jetë reformimi i arsimit profesional në vend, riformulimi dhe përfshirja në kurrikulat mësimore, trajnimi i mësuesve dhe instruktorëve, si dhe pajisja e shkollave dhe qendrave me bazën e nevojshme për këtë lloj arsimit.

Ligji i ri i AFP-së (2002), Konferenca II Kombëtare e AFP-së, Krijimi i Këshillit Kombëtar të AFP-së (2003), Strategjia e Punësimit dhe Formimit Profesional (SPFP), (2003), Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (Gusht 2004), si dhe fillimi i zbatimit (Mars 2004) i programit CARDS 2002 të BE-së, në mbështetje të AFP-së për Shqipërinë, i kanë dhënë një hapësirë të re nismave reformuese të këtij sektori të rëndësishëm të zhvillimit të burimeve njerëzore të vendit.

MASH po punon për përfshirjen e Strategjisë së Formimit Profesional në Arsimin Parauniversitar në strategjinë e rishikuar të Arsimit Basik. Një nga qëllimet përparësore të Strategjisë është sjellja e problematikës së aftësimit profesional të të rinjve në fokusin e diskutimeve në forume të niveleve të ndryshme, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e fuqizimit të këtij sektori.

Aftësimi si konsumatorë i të rinjve

Vizioni i Strategjisë është edukimi i fëmijëve dhe të rinjve si konsumatorë të përgjegjshëm, me qëllim zhvillimin e qëndrimit, të vlerave të orientimit

dhe sjelljes, në mënyrë që të fitohet ndërgjegjësimit kritik dhe ekologjik, si dhe përgjgjësi shoqërore. Vetëm duke rritur shkallën e ndërgjegjësimit të konsumatorëve shqiptarë do të mund të reduktohet shkalla e abuzimit ndaj tyre. Po aq sa kanë rëndësi të drejtat e njeriut për një demokraci, po aq vlerë ka për një ekonomi tregu respektimi i të drejtave të konsumatorëve.

Drejtimit përparësor do të jetë zhvillimi i veprimtarive të edukimit si pjesë integrale e programit të arsimit formal, ashtu edhe nëpërmjet veprimtarive jashtëshkollore. Në këtë drejtim rol aktiv duhet të luajnë jo vetëm institucionet shtetërore, po edhe shoqatat e konsumatorëve dhe organizatat jofitimprurëse rinore, të cilat duhet të mbështeten me burime financiare, për të realizuar projekte dhe veprimtari me të rinjtë. Me rëndësi të veçantë do të jetë forcimi i bashkëpunimit të ngushtë me aktorët e shoqërisë civile dhe të komunitetit të biznesit, si dhe sigurimi i asistencës së huaj për mbështetjen e programeve të veçanta.

Një nga përparësitë e tjera në këtë kuadër do të jetë ndërmarrja e fushatave ndërgjegjësuese ndaj konsumit të produkteve të parekomanduara ose që edhe ndalohen me ligj për grupmosha të caktuara si duhani, alkoli, lojërat e fatit etj. Pjesë e rëndësishme e ndërgjegjësimit do të jetë edhe publikimi i broshurave dhe fletëpalosjeve informative, si dhe organizimi i seminareve dhe workshop-eve në të gjithë vendin. Përqasja ndaj problematikës së aftësisë të të rinjve si konsumatorë duhet të bazohet në studimet e vazhdueshme për tregun e shërbimeve dhe të mallrave për të rinj dhe sjelljen prirjen e të rinjve ndaj tyre, të ndërmarrja nga institucionet e specializuara shtetërore të statistikës, institute kërkimore, si dhe subjekte private.

POLITIKAT

Punësimi i të rinjve

- Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në përgatitjen dhe miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit duhet të shohë me përparësi përfshirjen në mënyrë të veçantë të një kreu për nxitjen e punësimit të të rinjve në Shqipëri.
- Strategjia duhet të përmbajë një përshkrim të situatës së punësimit të të rinjve në vend, të tregut të punës dhe arsimit. Ajo duhet të përcaktojë objektivat e saj konkrete, indikatorët e matjes së arritjes të qëllimeve të vendosura, si dhe të ketë buxhet dhe planin e saj të veprimit.
- MTKRS në bashkëpunim edhe me OJF-të do të punojnë me MPÇSSHB-në për të zhvilluar programe trajnimi për të rinjtë, për të përmirësuar metodat e prodhimit agrikulturor dhe të marketingut, në

bazë të veçorive të nevojave rurale ekonomike në zona të ndryshme të vendit.

- Programet e ndërmarra për rritjen e punësimit rinor duhet t'u përgjigjen nevojave të kategorive të ndryshme, si gratë e reja, të rinjtë në zonat rurale, të rinjtë e marginalizuar, emigrantët e riatdhesuar, të pastrehët, familjet me shumë fëmijë dhe me të ardhura të pakta, të rinjtë që kthehen nga shërbimi ushtarak etj.
- Në kuadrin e programeve kombëtare të punësimit, të zbatuara nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, duhet të zhvillohet bashkëpunim i ngushtë me organizatat jofitimprurëse, të cilat ofrojnë punësim për të rinjtë, duke i mbështetur me një pjesë të fondeve të akorduara për këto programe. Meqenëse OJF-të nuk kanë për qëllim të krijojnë fitime nga marrja në punë e të rinjve, kjo do të ulte koston e marrjes në punë, si dhe do të forconte punën humanitare në komunitete.
- Në varësi edhe të realiteteve vendore, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta duhet të pilotojë gjatë vitit 2007 hapjen e një ose disa njësive të informacionit për punësimin e të rinjve në rrethe. Duke iu referuar planit të punës së kësaj Ministrie është rënë dakord për bashkëpunim, por pa kosto financiare nga ana jonë si Ministri. Kjo kosto do të mbulohet nga MPCSSH-bja dhe donatorët përkatës. Një përqasje efektive përbën pilotimin në bashkëpunim me OJF-të që kanë përvojë në fushën e shkëmbimit të informacionit dhe me rininë. Mësimet e nxjerra mund të ndihmojnë në krijimin e një modeli të suksesshëm të Njesisë së Informacionit për të Rinjtë, i cili mund të zbatohet në nivel kombëtar, duke nisur që nga viti 2009.

Thithja e trurit: të rinjtë që studiojnë jashtë vendit

- Hartimi dhe implementimi i politikave afatmesme dhe afatgjata për motivimin e kthimit të të rinjve, të cilët mbarojnë studimet jashtë vendit me një përqasje integruese, duke përfshirë bashkëpunimin e institucioneve shtetërore me shoqërinë civile dhe aktorë të organizatave ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri, si dhe me komunitetin e biznesit.
- Bashkëpunimi me organizata të ndryshme të cilat përfaqësojnë interesat e të rinjve që studiojnë jashtë vendit (si p.sh. rrjeti ASAN) për të lehtësuar komunikimin dhe bashkëpunimin e tyre të drejtpërdrejtë me institucionet publike.
- Promovimi i projekteve dhe programeve të cilat rrisin ndjenjën e përkatësisë kombëtare të studentëve që shkollohen nëpër botë.
- Mbështetja dhe zhvillimi i vazhdueshëm i programeve të intership-it me qëllim krijimin e mundësive për studentët që studiojnë jashtë

vendit, për t'u integruar në tregun e punës dhe zhvillimin e karrierës në Shqipëri.

- Ngritja e fondeve të nevojshme për krijimin e incentivave financiare për “kthimin” ose “qarkullimin” e trurit nëpërmjet ofrimit të pagave të larta për kategori të veçanta të të rinjve të kualifikuar jashtë vendit.
- Realizimi i studimeve të vazhdueshme të cilat sigurojnë të dhëna për studentët shqiptarë jashtë vendit, për degët që ata vazhdojnë, si dhe qëllimet dhe motivimet e tyre për të ardhmen. Krijimi i një baze të dhënash është vendimtar për formulimin e një përqsasjeje sa më pranë realitetit dhe sa më efektive ndaj çështjes së “largimit të trurit”.
- Vlerësimi i kërkesë-ofertës në tregun e punës në Shqipëri për orientimin e të rinjve shqiptarë që studiojnë jashtë shtetit në zgjedhjet e tyre për degët e studimit dhe fushat e kualifikimit.

Biznesi rinor dhe vetëpunësimi

- Është rënë dakord dhe do të bashkëpunohet me Dhomën e Tregëtisë dhe të Industrisë për hapjen e Njësive të Informimit mbi sistemin e taksave, legjislacionin shqiptar për hapjen e një biznesi, si dhe për mundësitë ku mund të investohet në ekonomi nga të rinjtë.
- Krijimi i një Fondi të Veçantë për Bizneset Rinore ose krijimi i lehtësive për të rinjtë që duan të hapin një biznes, për të marrë kredi afatgjata dhe me interesa të ulët nga bankat e nivelit të dytë. *Për këtë fond do të punohet me organizata e agjenci ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri si: British Council, USAID dhe sipas programeve të paraqitura në Planin e Veprimit 2007-2013.*
- Ngritja e kapaciteteve të institucioneve të trajnimit profesional për të krijuar mundësi të barabarta për vajzat dhe djemtë në zonat rurale dhe urbane, si mënyrë për t'i integruar ata në tregun e punës.

Formimi profesional i të rinjve

- Marrja e masave brenda vitit 2008 nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për ofrimin e kurseve të formimit profesional të lëvizshme për të rinjtë në zonat malore dhe rurale, sidomos për vajzat e reja dhe grupet e marginalizuara, bazuar në kërkesat që ka tregu i punës.
- Përfshirja e aftësimin profesional të të rinjve në përgjigje të sfidave që sjell integrimi ekonomik i vendit në rajon dhe në tregun e përbashkët të Bashkimit Europian. Për këtë qëllim, institucionet shtetërore dhe institutet kërkimore duhet të ndërmarrin studime të nevojave të tregut të punës, për të kaluar nga “riparimet e pjesshme sipas

nevojave të çastit” drejt “zgjidhjeve të plota e afatgjata” në kontekstin e integritit rajonal dhe europian.

- Krijimi i një sistemi unik dhe cilësor të aftësimit profesional nëpërmjet reformimit intensiv të sektorit, riformulimin e kurrikulave përkatëse, trajnimin e mësuesve dhe instruktorëve, si edhe përmirësimi i bazës materiale të institucioneve të edukimit të cilat ofrojnë arsim të profilizuar profesional për të rritur cilësinë e kualifikimit të marrë nga të rinjtë. Në kuadrin e përmirësimit të këtij sektori, duhet punuar në drejtim të rritjes së reputacionit të këtyre institucioneve të arsimit profesional për të rritur përqindjen e të rinjve (apo edhe të rriturve) që ndjekin këto programe.

Aftësimi si konsumatorë i të rinjve

- Ndërmarrja e fushatave ndërgjegjësuese ndaj konsumit të produkteve të parekomanduara ose që edhe ndalohen me ligj për grupmosha të caktuara si duhani, alkooli, lojërat e fatit etj. Në këtë kontekst, rëndësi të veçantë do të luajë publikimi dhe shpërndarja e materialeve informuese, si dhe organizimi i seminareve dhe workshop-eve në të gjitha rrethet e vendit.
- Zhvillimi i veprimtarieve edukuese jashtëshkollore për formimin e të rinjve si konsumatorë nëpërmjet bashkëpunimit të subjekteve shtetërore, organizatave të konsumatorëve dhe OJF-ve rinore.
- Rishikimi i kuadri rregullues i formave dhe etikës së marketingut të produkteve të dëmshme për shëndetin (si p.sh. duhani) nga bizneset përkatëse, duke u bazuar në reformat e ndërmarra nga vendet e zhvilluara të Bashkimit Europian për mbrojtjen e konsumatorëve nëpërmjet kontrollimit dhe kufizimit të promovimit të konsumimit të këtyre produkteve.
- Realizimi i studimeve periodike nga institucione të specializuara shtetërore të statistikës dhe institucione kërkimore për tregun e shërbimeve dhe të mallrave për të rinj, si dhe sjelljen dhe prirjet e të rinjve ndaj tyre.

Treguesit dhe burimet

Punësimi i të Rinjve

Niveli i punësimit sipas moshës

Sipas të dhënave nga INSTAT-i, niveli i punësimit nga mosha 18-25 vjeç varion nga 50.4 për qind në vitin 2002 deri në 41.2 për qind në vitin 2005.

Këto përqindje kanë premisa të shtohen me vënien në zbatim të PKV-së për vitet 2007-2011.

Veprimtaritë dhe programet për punësimin e të rinjve do të vihen në jetë nëpërmjet Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës etj.

Thithja e trurit

Nëpërmjet programeve të informacionit për shkollim jashtë vendit dhe integrimi i studentëve pas kthimit në vend synohet informimi dhe integrimi i studentëve që jetojnë dhe studiojnë në botë.

Kështu do të rritet numri i studentëve për praktika intership-i në administratën publike për të rinjtë që studiojnë jashtë.

Të rinjtë që studiojnë jashtë vendit kapin shifrën prej 24 për qind.

Vullnetarizmi rinor

Nxitja dhe promovimi i vullnetarizmit rinor ka një rol mjaft të rëndësishëm për zhvillimin e vendit dhe të rinjve. Nëpërmjet hartimit të legjislacionit për vullnetarizmin dhe krijimi i infrastrukturës administrative të zbatimit të tij, edukimi dhe promovimi i vullnetarizmit në sektorin e nevojave dhe të shërbimeve përparësore do të futen në të gjitha kurikulat si informacione për vullnetarizmin.

Do të ketë një rritje të numrit të shkëmbimeve vullnetare dhe bashkërendim me të madh në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

Biznesi rinor : vetëpunësimi i të rinjve

Ngritja e zyrave të informimit rinor në të gjitha rrethet do të ndikojë në rritjen e nivelit të informacionit për mundësitë e vendeve të punës për të rinjtë mbi baza vendore.

Duke qenë se shkalla e papunësisë për të rinjtë ka shkuar deri në 41.2 për qind në vitin 2005, nëpërmjet implementimit të SKR-së dhe programeve të ndryshme synohet ulja e numrit të të papunëve deri në 18 për qind. Ky është një synim i yni, duke iu referuar politikave dhe programeve që parashikohen në SKR dhe PKV 2007-2013.

Programi për nxitjen e vetëpunësimit të të rinjve do të bëjë të mundur krijimin e mundësive të vetëpunësimit.

Përqindja e të vetëpunësuarve ndaj totalit të të punësuarve në vitin 2002 ishte 72.5 për qind, ndërsa në vitin 2005 ishte 65.1 për qind sipas statistikave të INSTAT-it.

Aftësimi i të rinjve si konsumatorë

Gjatë viteve 2007-2011, nëpërmjet vënies në zbatim të PKV-së me veprimtari dhe programe konkrete në bashkëpunim me Zyrën e

Konsumatorit në Tiranë, do të organizohen trajnime dhe seminare njohëse për të rinjtë si konsumatorë.

IV. SHËNDETI DHE MBROJTJA SOCIALE

1. Shëndeti riprodhues (lufta kundër HIV/AIDS dhe SST-ve)
2. Abuzimi me drogat
3. Kriminaliteti rinor
4. Dhuna ndaj të miturve dhe të rinjve
5. Trafikimi dhe shfrytëzimi i të rinjve

KUSHTET AKTUALE

Shëndeti riprodhues (Lufta kundër HIV/AIDS dhe SST-ve)

Të rinjtë në Shqipëri përballen me të njëjtat sfida, si dhe pjesa tjetër e popullsisë në drejtim të çështjeve të shëndetit dhe kujdesit shëndetsor. Megjithatë, duke patur parasysh veçoritë e kësaj grupmoshe, kjo problematikë bëhet më e mprehtë në përballjen me çështje të shëndetit riprodhues, infeksioneve seksualisht të transmetueshme (IST) dhe infeksionit HIV/AIDS.

Me popullatën më të re në Europë, vendi ynë paraqitet në rrezik për përhapjen e infeksionit HIV/AIDS, veçanërisht në prani të shumë faktorëve socialë, ekonomikë dhe kulturorë që i bëjnë të rinjtë vulnerabël ndaj këtij infeksioni. Këta faktorë përfshijnë rritjen e përdorimit të drogave dhe veçanërisht atyre intravenoze, rritja e dukurisë së prostitucionit, i lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, emigracioni i lartë, dukuria e përjashtimit ose stigmatizimit të pjesëtarëve të grupeve të caktuara etnike ose sociale, siç janë përkatësisht romët ose meshkujt që bëjnë seks me meshkujt (MSM), rritja e numrit të të rinjve që braktisin shkollën etj.

Sipas të dhënave epidemiologjike të rasteve të raportuara me HIV/AIDS në Shqipëri, më shumë se dy të tretat e tyre i përkasin grupmoshës deri në 34 vjeç. Gjithashtu, gjatë viteve të fundit shihet një prirje rritjeje e numrit të rasteve me HIV të moshës 15 deri 24 vjeç. Pavarësisht numrit të vogël të rasteve të raportuara, të dhëna nga studime të ndryshme flasin për një rritje të numrit të rasteve me IST në Shqipëri. Deri në fund të vitit 2003, në Shqipëri janë identifikuar 138 raste me sifiliz. Studimi i survejancës biologjike dhe të sjelljeve i vitit 2005 tregoi për një prani të

infeksionit sifilitik dhe hepatitit B midis të rinjve MSM, përdoruesve të drogave intravenoze (PDI) dhe romeve.

Studime të ndryshme të kryera vitet e fundit në Shqipëri (*Studimi i Shëndetit Riprodhues 2002, Vlerësimi i shpejtë 2002, 2004 etj.*) kanë evidentuar mangësi të mëdha që ekzistojnë në njohuritë dhe ndërgjegjësimin e të rinjve rreth transmetimit dhe parandalimit të HIV/AIDS/IST, veçanërisht të rinjve që jetojnë në zonat rurale, atyre me nivel të ulët shkollimi, të rinjve emigrantë, grave të reja dhe të rinjve nga grupet me risk. Njohuritë e pakta dhe perceptimi i ulët i rrezikut nga të rinjtë, çojnë në praninë e një niveli të ulët të sjelljeve mbrojtëse, si dhe nivel të lartë të sjelljeve të rrezikshme.

Kësaj situatë nuk i përgjigjen shërbime ose ndërhyrje intensive dhe ekstensive, që paraqiten deficitare ose që mungojnë. Aksesit dhe cilësia e shërbimeve, që ofrohen për IST-në dhe SHR-në në nivele të ndryshme të kujdesit shëndetësor, janë mjaft të ulët. Stigma, që shoqëron IST-në dhe problemet e shëndetit riprodhues, shpesh nuk i lejon të rinjtë të kërkojnë ndihmë ose trajtim.

Programet aktuale të testimit dhe këshillimit vullnetar për HIV/AIDS janë ende të paorganizuar, ndërkohë që shfrytëzimi i rrjetit ekzistues është ende i ulët për shkak të stigmës dhe frikës së diskriminimit. Shpesh programet parandaluese nuk mbërrijnë te të rinjtë që kanë nevojë, veçanërisht ata vulnerabël ose të marginalizuar. Të rinjtë vazhdojnë të kenë akses të ulët ndaj metodave moderne kontraceptive, prezervativëve, si dhe ndaj shërbimeve të tilla si këshillimi ose edukimi mjekësor. Gjithashtu, të dhënat tregojnë se të rinjtë nuk i vizitojnë institucionet shëndetësore të kujdesit parësor, për të përfituar shërbime të shëndetit riprodhues.

Ligji për parandalimin e HIV/AIDS u miratua nga Kuvendi i Republikës në vitin 2002, ndërsa në vitin 2003 Qeveria miratoi Strategjinë Kombëtare që ka si qëllim madhor mbajtjen e Shqipërisë një vend me prevalencë të ulët të infeksionit HIV/AIDS.

Abuzimi me drogat

Vendet e Europës Lindore dhe Qendrore po përjetojnë një rritje të shpejtë të përdoruesve të drogës, kjo sepse shumica e tyre ndodhen pranë rrugëve të trafikut të drogës nga Afganistani drejt vendeve perëndimore dhe SHBA-së. Sipas UNODC-it, kjo dukuri është duke u zgjeruar, sepse dhe prodhimi i opiumit dhe kokainës po rritet.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë, në Shqipëri ka rreth 30000 përdorues të drogave, por burime të tjera flasin për një numër më të madh. Shifra e mësipërme është nxjerrë në vitin 2000. Gjithashtu

,Shqipëria është një vend ku prodhohet dhe trafikohet drogë, pra si rrjedhojë pritet që numri i përdoruesve të rritet dita-ditës. Raportet nga klientë që vizitojnë qendrën e Aksion Plus-it, tregojnë se mosha e fillimit të përdorimit të drogës është 13-14 vjeç dhe shumica e tyre kanë një histori 8 -10-vjeçare të përdorimit të disa drogave. Fillimisht ata kanë përdorur droga të ashtuquajtura të lehta, për të kaluar më tej në droga të “rënda” si heroina, dhe shumë prej tyre tashmë e injektojnë heroinën. Shumica e përdoruesve përdorin kanabis, por ka një rritje të personave që janë të varur nga heroina.

Problemi i drogës është shtrirë në mbarë vendin, por është më i mprehtë në zonat urbane të Tiranës, Shkodrës, Vlorës, Fierit, Lushnjës, Korçës, si dhe Gramshit. Vdekjet nga mbidoza kanë qenë rreth 40, por rastet e vdekjeve mund të jenë më të larta si pasojë e mosraportimeve të sakta. Përdorimi intravenoz i drogave është një shkak themelor për përhapjen e HIV/AIDS dhe infeksioneve të tjera seksualisht të transmetueshme. Vlerësohet se rreth 8000-10000 përdorues injektojnë, kryesisht heroinë, si dhe përdorin të njëjtat shiringa, duke shtuar rreziqet për shëndetin e përdoruesit. Kohët e fundit kemi një rritje të përdoruesve midis anëtarëve të komunitetit rom. Ky komunitet, përveç drogës është i prekur nga papunësia, varfëria e thellë, akses i ulët ndaj shërbimeve shëndetësore. Romët, gjithashtu, kanë një nivel të ulët informacioni dhe injektojnë në kushte të këqija higjienike, duke shtuar kështu edhe rreziqe të tjera shëndetësore.

Përdoruesit e drogës mund të kenë pasojat serioze për shëndetin dhe mirëqenien sociale. Ata shpesh nuk përfitojnë nga shërbimet e shëndetit publik si pasojë e stigmës dhe diskriminimit. Pasojat shëndetësore të përdorimit të drogave (veçanërisht të atyre që injektojnë) do të vijnë të përkeqësohen, ndërsa rritet barra e disa sëmundjeve të tjera që lidhen me përdorimin e drogës. Epidemitë e malarjes, tetanozit, hepatiti C (HCV), infeksione të tjera me natyrë parazite ose bakteriale, bashkë me disa sëmundje të tjera, i atribuohen përdorimit të drogave. Një seri e gjerë e komplikacioneve infektive e lidhur me injektimin e drogave është dokumentuar që në raportet të hershme. Infeksioni i HIV-it ka marrë përmasa dramatike dhe ka ndryshuar perceptimin e grupeve të përdoruesve të drogës.

Ekzistojnë disa nivele të trajtimit të këtij problemi, ku mund të përmendim atë parandalues, nivelin trajtues të përdoruesve të lehtë të drogës dhe nivelin trajtues të përdoruesve të rëndë. Megjithatë, niveli i bashkërendimit midis strukturave qeveritare dhe joqeveritare në luftën kundër përdorimit të drogave është ende i ulët dhe duhet të fuqizohet më tej, me qëllim që të ndërhyhet në kohë.

Gjatë viteve të fundit, shumë të rinj po përdorin pije alkoolike në vendet e zhvilluara dhe ato të pazhvilluara. Konsumi i tepruar i alkoolit krijon

probleme të panumërta shëndetësore, si dhe shkurton jetën. Ata që pijnë shumë alkool janë të rrezikuar nga kanceri, ulçera, sëmundjet e zemrës dhe ciroza e mëlçisë. Gjithashtu, alkooli ul aftësinë për të gjykuar siç duhet, dhe të rinjtë janë të prirur për t'u përfshirë në veprimtari kriminale, si dhe në sjellje të tjera të rrezikshme.

Një nga format e sjelljeve që po dëmton më shumë të rinjtë dhe shëndetin e tyre është duhanpirja. Në botë rreth 13500 njerëz vdesin në ditë nga pirja e duhanit dhe çdo cigare e pirë shkurton 7 minuta jetë. Të rinjtë janë veçanërisht të rrezikuar, sepse pasojat e dëmshme fizike dhe psikologjike shfaqen pas dy ose tri dekadash. Duhanpirja zvogëlon aftësinë imunitare të trupit, si dhe shkakton probleme me aparatit e frymëmarrjes – për të përmendur disa nga dëmet e shumta, të pakthyeshme. Sipas studimeve të shumta, ka shumë të ngjarë që duhanpirësit të jenë përdorues të rregullt të alkoolit dhe të eksperimentojnë me droga të tjera.

Shënim:

Me termin *droga* klasifikohen të gjitha ato substanca të cilat kanë efekt fizik ose psikologjik te personi që i përdor, të tilla si: opiatet/opioidët, halucinogenët, kanabinoidët, stimulantët, sedativët, solventët, alkooli, duhani dhe droga të tjera artificiale.

Kriminaliteti rinor

Përfshirja e të miturve dhe të rinjve në vepra penale, ndonëse mbetet në nivele të ulta, përsëri ka ardhur duke u rritur nga viti në vit. Grupmoshat e të rinjve 14-18 vjeç dhe sidomos 20-30 vjeç janë më të rrezikuarat nga përfshirja në krime dhe kundravajtje penale, si ndaj vetë të rinjve, ashtu edhe ndaj personave të tjerë.

Kriminaliteti rinor është i lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me përjashtimin social dhe mungesën e aksesit në arsim, informacion, kulturë, punë dhe pamundësinë për të jetuar në mirëqenie. Këtyre faktorëve i shtohen edhe faktorë të tjerë objektivë dhe subjektivë si dhuna në familje, divorcet, dhuna në shoqëri dhe në shkollë, mungesa e programeve të parandalimit të kriminalitetit fëmijor, programeve të rehabilitimit etj. Në fakt, kriminaliteti është më i përhapur në zonat ku ka mungesë të rendit, ku ka varfëri dhe migracion ose ku forca e ligjit është e dobët.

Të dhënat tregojnë se ka një rritje të kriminalitetit rinor, sidomos në ato zona periferike që kanë kulturë të qëndrueshme. Në shumë raste, të rinjtë shkelës të ligjit janë të rinj që vijnë nga familje të varfra, të ekspozuar ndaj dhunës që në fëmijëri, që kanë braktisur shkollën

dhe/ose komuniteti nuk iu siguron mundësi përfshirjeje në veprimtari të formimit profesional, kulturor dhe programe punësimi.

Mungesa e ligjeve të përshtatshme për të rinjtë, e masave alternative të dënimit dhe e institucioneve të vuajtjes së dënimit të përshtatshme për fëmijët dhe të rinjtë, e bën situatën edhe më të vështirë. Një nga përmasat më kritike të problemit qëndron edhe në mungesën e kuadrit të nevojshëm ligjor dhe institucional për të mbrojtur të rinjtë, të cilët kalojnë grupmoshën që përfiton trajtim dhe status të veçantë nga konventat ndërkombëtare që mbrojnë fëmijët.

Shpesh të rinjtë përsëritës vijnë nga përvoja të shkeljes së ligjit të patrajtuar, ku institucionet e vuajtjes së dënimit për rehabilitimin e të riut nuk kanë bashkëpunuar me shërbimet sociale, shkollën, organet e drejtësisë, familjen dhe komunitetin. Pasojat e mosadresimit të kriminalitetit rinor krijojnë premisa për zhvillime negative në gjirin e shoqërisë dhe atë të biznesit, si dhe shtojnë mundësinë e rritjes së klimës së mosbesimit ndaj qeverisë. Për këtë qëllim ndërhyrja në këtë nivel mund të përcaktohet si emergjente.

Dhuna ndaj të miturve dhe të rinjve

Një nga përmasat më problematike të periudhës së vështirë të tranzicionit paskomunist në vend është shtimi i dhunës dhe i vetëvrasjes të të rinjtë dhe të vajzat e reja. Dhuna në pjesën më të madhe të rasteve manifestohet si një dhunë fizike, psikologjike/emocionale dhe seksuale. Fëmijët dhe të rinjtë mbeten të pambrojtur dhe vulnerabël, meqenëse në vendin tonë ende nuk ekziston një ligj i posaçëm kundër dhunës në familje – ndërkaq, kjo çon edhe kah kufizimit të raportimit të saj dhe perceptimit të qytetarëve, se nuk ekzistojnë masa mbrojtëse për këtë dukuri.

Aspekt tejet i rëndësishëm i situatës aktuale është edhe mungesa e studimeve të veçanta në lidhje me problemin e dhunës ndaj të rinjve. Studimet ekzistuese i referohen më shumë fëmijëve dhe nuk ka analiza të mirëfillta për shkaqet dhe pasojat që sjell dhuna në jetën e të rinjve, parë si një kategori më e gjerë. Në këtë kontekst, mungojnë të dhëna statistikore të sakta edhe për karakteristikat socio-ekonomike dhe bazën gjinore të dhunës në realitetin shqiptar. Ndërkaq, fakte të njohura janë se grupet më të riskuara konsistojnë në fëmijët dhe të rinjtë nga shtresat e varfëra të shoqërisë, si edhe vajzat e reja.

Dukuria e dhunës, ndonëse nuk është e re, mbetet e fshehtë dhe mendësia e familjes, shoqërisë dhe individit të edukuar në këtë familje dhe shoqëri bën që të mos ndërhyet aq sa duhet dhe të parandalohet dhe të trajtohet që në fazat e para. Problem është edhe fakti se shumë

prindër dhe mësues në Shqipëri ende mendojnë se disiplinimi fizik bën pjesë në rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre. Kjo reflektohet edhe në mungesën e një Kodi Etik Pedagogjik, i cili përcakton qartësisht etikën e sjelljes së mësuesve ndaj nxënësve, duke ndaluar kategorikisht ushtrimin e dhunës.

Një nga aspektet më problematike të situatës aktuale është jo vetëm pamjaftueshmëria e fushatave sensibilizues, por edhe niveli i ulët i shërbimeve këshilluese dhe rehabilituese. Mbetet shumë për të bërë si nga instancat shtetërore, ashtu edhe aktorët e shoqërisë civile dhe të organizatave ndërkombëtare që operojnë në vend, për të edukuar dhe fuqizuar të rinjtë në mënyrë që ata të mund t'i rezistojnë "institucionit të dhunës". Në këtë drejtim, një çështje me tejet rëndësi është edhe rregullimi ligjor i funksionimit të mediave pamore dhe të shkruara, të cilat ofrojnë dhe riprodhojnë produkte komerciale që lidhen me kulturën e dhunës, në emër të një shoqërie të informacionit intensiv.

Trafikimi dhe shfrytëzimi i të rinjve

Trafikimi i qenieve njerëzore vazhdon të mbetet ende një problem kritik për Shqipërinë. Periudha e tranzicionit ka sjellë shfaqjen dhe konsolidimin e krimit të organizuar, i cili viktimizon fëmijët dhe të rinjtë për prostitucion, punë skallëvëruese, dhurim organesh dhe shërbime të tjera mjaft të kërkuara në vendet e zhvilluara që përbëjnë pjesën më të madhe të destinacionit përfundimtar të trafikimit të qenieve njerëzore. Në të vërtetë, sipas një studimi të Departamentit të Shtetit në ShBA, përllogaritet se industria e trafikimit në nivel global arrin rreth \$9 bilion në vit, çka dëshmon për ekzistencën e forcave të fuqishme të kërkesës së tregut për këto shërbime.

Ndërkaq, rol kyç luajnë edhe forcat e ofertës së rrjeteve të krimit të organizuar në vend. Varfëria e lartë, migrimi i brendshëm, humbja e një sërë vlerash shoqërore për shkak të tranzicionit dhe shfrytëzimi i fëmijëve dhe të rinjve për punë të detyruar, janë faktorë që nxisin trafikimin ndërmjet të rinjve, si të djemve, ashtu edhe vajzave. Ndërkohë kategoritë më të riskuara për t'u shëndërruar në viktime të trafikimit njerëzor përbëjnë më së shumti moshat e reja dhe të pambrojtura, të rinjtë nga shtresat më të varfra dhe kryesisht nga zonat rurale në Shqipëri, si edhe vajzat dhe gratë e reja.

Mungesa e stabilitetit politik dhe tranzicioni problematik ekonomik gjatë viteve '90 kanë krijuar një terren të favorshëm për zhvillimin e trafikimit, i cili mori hov edhe për shkak të veçantive të transformimeve në rajon. Kështu, një nga problemet kryesore ka qenë paaftësia e organeve shtetërore për t'u përballur me situatën dhe për të luftuar efektivisht veprimtarinë e trafikimit të organizatave kriminale në vend. Megjithatë,

miratimi nga Qeveria i një sërë ligjeve dhe politikave kundër trafikimit, si dhe forcimi i institucioneve të zbatimit të ligjit kanë patur një ndikim pozitiv në drejtim të uljes së numrit të personave të trafikuar, si dhe të riskut për t'u bërë viktimë të trafikimit.

Ndryshimet në Kodin Penal dhe miratimi i Strategjisë Kombëtare Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (2001) dhe i Strategjisë Kombëtare Kundër Trafikimit të Fëmijëve (2004), të komplementuara me nënshkrimin e një sërë marrëveshesh të dyanshme dhe të shumanshme ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera, përbëjnë një garanci më shumë në luftën e Qeverisë Shqiptare, për të zhdukur këtë dukuri negative.

VIZIONI, PËRPARËSITË DHE QËLLIMET STRATEGJIKE

Shëndeti riprodhues (Lufta kundër HIV/AIDS dhe SST-ve)

Vizion i Strategjisë është promovimi dhe sigurimi i një shëndeti riprodhues për rininë, duke mbajtur në shifra sa më të ulta prevalencën e infeksionit HIV/AIDS, SST-ve, të shtatzanisë së padëshiruar dhe të aborteve të pasigurta. Përmbushja e këtij vizioni strategjik kërkon përmirësimin e njohurive, të qëndrimeve, aftësive dhe sjelljeve të të rinjve nëpërmjet zbatimit të programeve shkollë, komunitet, mass media dhe vendin e punës, si dhe institucionet shëndetësore.

Në këtë kuadër përparësi përbën rritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive si dhe luftimi i qëndrimeve, miteve dhe keqkuptimeve që ekzistojnë te të rinjtë rreth çështjeve të ndryshme të seksualitetit dhe shëndetit riprodhues. Gjithashtu, një përparësi tjetër është rritja e nivelit të aftësive parandaluese nëpërmjet uljes së sjelljeve të rrezikshme mes të rinjve, aksesit dhe përdorimit nga të rinjtë të metodave moderne kontraceptive. Rëndësi të veçantë do të luajë krijimi i një mjedisi mbështetës për të rinjtë, si dhe përfshirja e tyre e drejtpërdrejtë në planifikimin dhe implementimin e politikave rinore për shëndetin riprodhues.

Arritja e qëllimeve strategjike do të kërkojë një angazhim shumëpalësh të institucioneve shtetërore, të tregut privat të mjekësisë, si dhe të OJQ-ve rinore që veprojnë në këtë sektor për zgjerimin, përmirësimin dhe intensifikimin e shërbimeve miqësore për të rinjtë. Përparësi do t'i jepet përmirësimit të funksionimit të klinikave të kontrollit të shëndetit, veçanërisht në zonat rurale, garantimit falas ose me çmime të reduktuara të shërbimeve bazë, veçanërisht gjatë adoleshencës, si dhe sigurimit të barazisë gjinore në aksesin ndaj shërbimeve mjekësore.

Tjetër aspekt thelbësor mbetet angazhimi i Ministrisë së Arsmit dhe Shkencës për përmirësimin e programeve mësimore për jetën, mirëqenien

shëndetësore dhe shëndetin riprodhues. Gjithashtu, përparësi i duhet dhënë përfshirjes së qendrave të këshillimit nëpër shkolla të nivelit parësor dhe dytësor, të cilat mund të ofrojnë informacion mbi shëndetin riprodhues, mirushqyerjen dhe planifikimin familjar.

Abuzimi me drogat

Vizioni i Strategjisë për abuzimin me drogat është edukimi dhe mbrojtja e të rinjve për të qenë pjesëtarë të shëndetshëm të shoqërisë, të pavarur nga përdorimi substancave. Në veçanti, përqsja strategjike përfshin parandalimin e përdorimit të drogave, rehabilitimin e përdoruesve, si edhe zvogëlimin e dëmit ose rreziqeve që lidhen me përdorimin e drogave.

Problematika e drogës duhet të trajtohet si përparësi me rëndësi nga ana e qeverisë vendore dhe qendrore me pikësynim parandalimin dhe abuzimin me drogat, si dhe luftimin e krimit të organizuar dhe biznesit të ndyrë të drogave. Në veçanti, duhen zhvilluar programet e zvogëlimit të dëmit ose trajtimit të drogës, që aktualisht janë në nivel shumë të kufizuar. Gjithashtu, institucionet shtetërore duhet të bashkëpunojnë ngushtësisht me aktorë të shoqërisë civile, për të ndërgjegjësuar të rinjtë kundër përdorimit të substancave, si dhe për të qenë pranë atyre që kanë nevojë për ndihmë dhe trajtim.

Domosdoshmëri përbën identifikimi dhe sigurimi i më shumë burimeve njerëzore dhe materiale për trajtimin e dukurisë së drogës. Ndërkaq, përdorimi i frutshëm i burimeve të vëna në dispozicion dhe hartimi i politikave realiste kërkon krijimin e një sistemi monitorimi dhe vlerësimi për programet kundër abuzimit me substanca si për vajzat, ashtu edhe për djemtë. Në këtë kontekst, rëndësi të veçantë ka edhe grumbullimi i të dhënave statistikore dhe kryerja e studimeve për dukurin e drogës në vend.

Kriminaliteti rinor

Vizioni i Strategjisë për çështjen e kriminalitetit rinor frymëzohet nga respekti për të drejtat e të miturve dhe të rinjve në konflikt me ligjin. Përmëshja e tij përcakton si përparësi angazhimin për të përmirësuar punën parandaluese, zbatimin e masave alternative të dënimit, forcimin e zbatimit të ligjit, krijimin e infrastrukturës së përshtatshme për vuajtjen e dënimit për të miturit dhe të rinjtë, si dhe riintegrimin e tyre në shoqëri.

Një nga qëllimet kryesore strategjike është krijimin e një kuadri ligjor të plotë në koherencë me detyrimet e Shqipërisë karshi Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe rekomandimeve të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës. Po në këtë kontekst, rëndësi kritike ka bashkëpunimi i institucioneve shtetërore me UNICEF-in dhe shoqërinë civile për krijimin

e një sistemi funksional të administrimit të drejtësisë për të rinjtë. Përparësitë përfshijnë hapjen e mjediseve të veçanta të paraburgimit dhe vuajtjes së dënimit, si dhe zbatimin e masave alternative ndëshkimore. Ndërkohë një tjetër drejtim përparësor përbën ngritja e një sistemi të parandalimit të kriminalitetit fëmijor dhe atij rinor nëpërmjet vendosjes së masave të përkujdesit dhe asistencës për të gjithë të miturit që shfaqin sjellje ose prirje penale.

Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, si dhe të linjës, do të punojë për krijimin e një pakete ligjore për të rinjtë.

Dhuna ndaj të miturve dhe të rinjve

Vizioni i strategjisë mbi dukurinë e dhunës është sigurimi i mbrojtjes së të miturve dhe të rinjve nga ekspozimi ndaj dhunës, abuzimit dhe formave të tjera të keqtrajtimit, si dhe ofrimit të mbështetjes psiko-sociale dhe këshillimeve për viktimat. Element kritik i vizionit strategjik është përfshirja e drejtpërdrejtë e vetë të rinjve në luftën kundër dhunës, si dhe fuqizimi i tyre për zhvillimin e veprimtarive që adresojnë racizmin, ksenofobinë, diskriminimin dhe format e dhunës me bazë gjinore që ndikojnë në jetën e tyre.

Përparësi në përmbushjen e këtij vizioni është bashkërendimi i punës së institucioneve publike dhe shoqërisë civile në sensibilizimin, fuqizimin dhe mobilizimin e komunitetit, për të parandaluar dhunën ndaj të rinjve. Në këtë kuadër, theksi duhet vendosur mbi zhvillimin e veprimtarive formale, joformale dhe ndërkulturore për të gjithë aktorët në fushën e parandalimit dhe të trajtimit të dhunës dhe të diskriminimit. Në veçanti duhet të bashkëpunohet me drejtuesit e shkollave, mësuesit, prindërit dhe vetë të rinjtë për të zhdukur të gjitha format e dhunës në shkollë dhe jashtë saj.

Një tjetër përmasë përparësore është mbledhja e statistikave dhe realizimi i studimeve me qëllim hartimin e programeve kombëtare dhe vendore, si dhe monitorimin dhe vlerësimin e nismave që adresojnë dukurinë e dhunës si për vajzat, ashtu edhe për djemtë. Element me rëndësi i programeve të ndërmarra do të jetë pjesëmarrja e të rinjve në nivel vendor dhe kombëtar për adresimin e problematikës së dhunës, duke zgjedhur modelet më efektive në përputhje me grupet dhe nevojat e tyre të veçanta.

Qëllimi strategjik i angazhimeve të Qeverisë dhe aktorëve të tjerë në këtë sektor synon formimin e të rinjve me aftësitë dhe qëndrimet e duhura për t'u mbrojtur nga dhuna, promovimi i një kulture kundra diskriminimit dhe dhunimit me bazë gjinore, si dhe ndërgjegjësimin e të rinjve për natyrën kriminale të dhunës në familje. Gjithashtu, rol kyç do të luajë trajnimi i vazhdueshëm i stafit pedagogjik dhe i personelit shëndetësor

mbi pasojat fizike, mendore dhe shëndetësore të dhunës të vajzat dhe djemtë në lidhje me mirëqenien dhe shëndetin.

Trafikimi dhe shfrytëzimi i të rinjve

Vizioni i Strategjisë është angazhimi për zhdukjen plotë të trafikimit dhe shfrytëzimit të të rinjve në Shqipëri, si dhe krijimin e mekanizmave dhe formave të duhura për mbështetjen e viktimave të trafikimit në procesin e integritetit të tyre në jetën shkollor dhe profesionale.

Përparësi në arritjen e këtij vizioni strategjik nga instancat qeveritare do të jetë adresimi i shkaqeve, të cilat nxisin trafikimin, dhe luftimi i rrjeteve të krimit të organizuar. Në veçanti, fuqizimi ekonomik dhe mbrojtja sociale e të rinjve, të cilët gjenden nën riskun e të qenit të trafikuar, do të jetë qëllim strategjik i bashkëpunimit shumëpalësh të institucioneve publike, aktorëve të shoqërisë civile, si dhe të organizmave ndërkombëtarë që operojnë në Shqipëri dhe rajon. Tjetër angazhim përparësor është organizimi i fushatave ndërgjegjësuese në bashkëpunim me median për sensibilizimin e publikut për dukurinë e trafikimit, duke i dhënë fokus të veçantë mbrojtjes së vajzave dhe grave të reja.

Grumbullimi i të dhënave statistikore dhe kryerja e studimeve ndërdisiplinore përbën një qëllim të rëndësishëm për hartimin dhe zbatimin e programeve kombëtare dhe vendore në përgjigje të dukurisë së trafikimit, për të arritur optimalizimin e burimeve njerëzore dhe materiale në dispozicion.

Një qëllim strategjik me përparësi është edhe angazhimi i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për përfshirjen në programet mësimore të ciklit të mesëm dhe atij të lartë për informimin mbi rrezikun e trafikimit dhe pasojat e tij të rinia. Ndërkaq një rol të rëndësishëm do të luajë edhe bashkërendimi i punës së Ministrisë të Turizimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me OJF-të rinore për konceptimin dhe zbatimin e formave krijuese të edukimit joformal të të rinjve mbi problematikën e trafikimit.

POLITIKAT

Shëndeti riprodhues (Lufta kundër HIV/AIDS dhe SST-ve)

- Përmirësimi i bashkërendimit të punës midis institucioneve qeveritare, organizatave ndërkombëtare dhe aktorëve të shoqërisë civile për hartimin dhe zbatimin e programeve ndërgjegjësuese të përshtatshme nga aspekti kulturor për rininë.
- Krijimi dhe forcimi i rrjeteve të organizatave rinore që ofrojnë shërbime në fushën e shëndetit riprodhues, luftës kundër HIV/AIDS

dhe SST-ve me qëllim bashkërendimin e veprimtarive në planin kombëtar dhe rajonal.

- Mbështetja dhe fuqizimi i qendrave rinore për t'i kthyer ato në qendra që ofrojnë një mjedis të sigurt, mbështetës dhe miqësor, ku të rinjtë të kenë akses ndaj këshillimit, kontraceptivëve, shërbimeve klinike parandaluese dhe trajtimit. Këto qendra rinore janë në Tiranë dhe në rrethe të ndryshme të vendit, përgjegjëse e të cilave do të jetë Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Shëndetësisë, të mbështetura dhe nga donatorët (UNFPA & UNICEF etj.).
- Zhvillimi i fushatave sensibilizuese mediatike me synim ndryshimin e normave sociale, besimeve individuale dhe sjelljeve të rinjve, që lidhen me shëndetin riprodhues, parandalimin e HIV/AIDS dhe SST-ve, si dhe me planifikimin familjar. Rëndësi kritike në këtë drejtim luan konceptimi i programeve ndërgjegjësuese që marrin parasysh karkarakteristikat përkatëse të kategorive vulnerabël, si të rinjtë jashtë shkolle, në zonat rurale, emigrantët, të rinjtë romë, punëtorët e seksit, PDI, MSM dhe grupe të tjera të marginalizuara.
- Hartimi dhe zbatimi i projekteve që synojnë drejt barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave nëpërmjet rritjes së aksesit ndaj informacionit për planifikimin familjar, shëndetin seksual, shërbimet shëndetësore dhe alternativat që u ofrohen viktimave të dhunës seksuale.
- Angazhimi i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe Ministrisë së Shëndetësisë për përmirësimin e kurrikulës mësimore për shëndetin riprodhues dhe edukatën seksuale në ciklin fillor dhe të mesëm, si dhe për ngritjen e njësive shëndetësore në mjediset shkollore.
- Ngritja dhe forcimi i grupeve të edukatorëve bashkëmohatarë (*peer education*). Edukimi bashkëmohatar duhet të synojë kryesisht në promovimin e sjelleve të shëndetshme si: shtyrja e debutimit seksual midis adoleshentëve; promovimi i besnikërisë; reduktimi i partnerëve seksualë; komunikimi efektiv midis partnerëve; rritja e përdorimit të prezervativit; promovimi i metodave kontraceptive; rritja e kërkesës për kujdes shëndetësor; përmirësimi i perceptimit të riskut; rritja e shërbimeve të ndryshme të shëndetit riprodhues; si dhe planifikimi familjar.
- Organizimi i programeve pilot për promovimin e përdorimit konsistent të kondomëve nga djemtë nëpërmjet instalimit të makinave shpërndarëse pranë universiteteve.

- Trajnimi i personalit mjekësor parësor dhe spitalor, si dhe punonjësve të tjerë socialë, për të ofruar shërbime miqësore për të rinjtë në fushën e shëndetit riprodhues dhe të planifikimit familjar.
- Krijimi i mekanizmave monitorues për të mundësuar vlerësimin e situatës së shëndetit riprodhues, HIV/AIDS-it dhe SST-ve midis të rinjve, si dhe vlerësimin e frytshmërisë së programeve të ndërmarra në nivel rajonal dhe kombëtar, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të përjasjes ndaj problematikës së gjerë të shëndetit riprodhues dhe planifikimit familjar.
- Grumbullimi i të dhënave statistikore me qëllim krijimin e një baze të dhënash të plota për shëndetin riprodhues të rinisë dhe kryerja e studimeve që synojnë zgjerimin e njohurive mbi faktorët mbrojtës dhe problematikën e rrezikut të rinjtë.

Abuzimi me drogat

- Promovimi i parandalimit të abuzimit me drogat përmes programeve edukative shkollore nëpërmjet angazhimit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për përfshirjen e problematikës së drogave në ciklin e mesëm.
- Zhvillimi i kurseve të trajnimit dhe shpërndarja e materialeve informative për studentët, mësuesit, prindërit dhe punonjësit socialë, me synim aftësimin e tyre për të identifikuar dhe diagnostikuar herët abuzimin me substancat.
- Krijimi pranë shkollave të mesme i mjediseve miqësore për të rinjtë në përgjithësi dhe për ata që kanë probleme me drogën në veçanti, për edukimin mbi abuzimin me drogat dhe mbështetjen e përdoruesve për të marrë vendimet e duhura vetjake për një “jetë pa drogë”.
- Angazhimi i mediave elektronike dhe të shkruara në sensibilizimin e publikut të gjerë dhe të rinjve në veçanti mbi drogat, si edhe trajnimi i gazetarëve me qëllim aftësimin e tyre për realizimin e fushatave sa më efektive në transmetimin e një mesazhi domethënës dhe pozitiv për grupet vulnerabël.
- Mbështetja e OJF-ve rinore në ngritjen dhe realizimin e programve të edukimit dhe këshillimit individual, për të nxitur integrimin e rinisë në komunitet, për të zhvilluar një stil të shëndetshëm jetese, si dhe për të rritur ndërgjegjësimin për dëmet e shkaktuara nga droga.
- Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese me qëllim uljen e përdoruesve që injektojnë drogat, ndalimin/zvogëlimin e ripërdorimit të shiringave, rritjen e shkallës së dizinfektimit të ageve dhe shiringave, si dhe

rritjen e përdorimit të prezervativit dhe metodave të tjera kontraceptive.

- Mbështetja e zgjerimit të terapive zëvendësuese (p.sh. me metadon) ose terapive të tjera rehabilituese pa medikamente nëpër rrethet e tjera, ku shërbimet për përdoruesit mungojnë pothuasje plotësisht.
- Sigurimi i respektimit të të drejtave njerëzore për përdoruesit e drogave nëpërmjet mbrojtjes nga diskriminimi, si dhe ruajtjes së konfidencialitetit. Përdoruesit e drogave janë qytetarë me të drejta të plota dhe kushte shëndetësore të veçanta, dhe nuk janë kriminelë të papërgjegjshëm.
- Krijimi i mekanizmave monitorues, grumbullimi i të dhënave statistikore për situatën e përdorimit të substancave të djemtë dhe vajzat, si dhe mbështetja e punimeve studimore për problematikën e abuzimit me drogat, me synim përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të ndërmarra në nivel kombëtar dhe rajonal.

Kriminaliteti rinor

- MTKRS do të bashkëpunojë me MD-në për përfundimin dhe miratimin e Paketës së Reformës Ligjore për të Miturit, nëpërmjet një përjasjeje integruese, e cila merr në konsideratë edhe qëndrimet e grupeve të interesuara ose të prekura nga kjo paketë.
- Përgatitja e Kodit të Drejtësisë për të Miturit nga Ministria e Drejtësisë, në përputhje të plotë me Konventën për të Drejtat e Fëmijës, me synim krijimin e bazave të qëndrueshme të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve në vend.
- Përgatitja e paketës ligjore për Masat Alternative për të Miturit dhe të Rinjtë nëpërmjet diskutimit të të gjithë partnerëve socialë të implikuar, nën drejtimin e përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe UNICEF-it brenda vitit 2007. Qëllimi i paketës lidhet me rritjen e mundësisë së rehabilitimit dhe zbatimit të drejtësisë rehabilituese në të gjitha rastet e përshtatshme, si dhe në minimizimin e faktorëve që ndikojnë që të rinjtë të bëhen recidivistë.
- Zbatimi nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës të programeve që nxisin tolerancën, mirëkuptimin dhe zgjidhjen e konflikteve. Këto nisma drejtohen nga një përjasje, e cila i sheh shkollat si qendra komunitare, ku ofrohen programe edukimi, sensibilizimi, parandalimi për çështjet që lidhen me kriminalitetin rinor.
- Ndërmarrja e fushatave kombëtare informuese dhe edukative që kanë për qëllim sensibilizimin e të rinjve mbi efektet vetjake dhe sociale të

dhunës në familje, shkollë, komunitet dhe shoqëri, si dhe pasojat negative të përfshirjes në vepra penale. Organizimi i këtyre fushatave ndërgjegjësuese do të realizohet nëpërmjet angazhimit shumëpalësh midis Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Rinisë dhe Ministrisë së Arsimit, si dhe bashkëpunimit me OJF-të rinore që operojnë në këtë sektor.

- Ngritja e një sistemi të parandalimit të kriminalitetit fëmënor dhe atij rinor që synon vendosjen e masave të përkujdesit dhe asistencës për të gjithë të miturit që shfaqin sjellje ose prirje penale, si angazhim i përbashkët i Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, MPCSSHB.

Dhuna ndaj të miturve dhe të rinjve

- Zhvillimi i veprimtarive sensibilizuese për parandalimin e dhunës ndaj të miturve dhe të rinjve, nëpërmjet përfshirjes së tyre të drejtpërdrejtë në hartimin dhe organizimin e këtyre nismave. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar rritjes së ndërgjegjësimit të grave të reja dhe fëmijëve në lidhje me respektimin e të drejtave të tyre.
- Ndërgjegjësimi dhe informimi i mediave për edukimin e të rinjve me mesazhe antidhunë, të cilat reflektojnë vlerat e tolerancës dhe nxisin barazinë gjinore të të rinjtë dhe zhdukjen e formave të dhunës me bazë gjinore.
- Mbështetja e veprimtarive formale dhe joformale të edukimit bashkëmohatar, duke marrë në konsideratë rolin tejet të rëndësishëm që ai luan, meqenëse ndikimi i bashkëmohatarëve është mjaft i rëndësishëm në jetën e të rinjve. Në këtë kuadër, duhet të mbështet krijimi i programeve komunitare për fëmijët dhe të rinjtë, ku ata mund të mblidhen dhe të flasin për problemet e tyre, si dhe trajtimi për zgjidhjen paqësore të konfliktit.
- Organizimi i programeve të trajnimit me qëllim rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të punonjësve të policisë, mjekëve, punonjësve socialë dhe komunitetit në tërësi për problemet e dhunës ndaj të rinjve.
- Krijimi i grupeve ndërdisiplinore për trajtimin dhe rehabilitimin mjekësor, psikologjik dhe social të të gjitha kategorive të dhunës, si edhe zbatimi i programeve nëpër institucionet edukuese për mbështetjen sociale dhe mjekësore për fëmijët dhe të rinjtë e dhunuar.
- Realizimi i monitorimeve dhe vlerësimeve me pjesëmarrjen e vetë të rinjve, me synim përmirësimin e adresimit të nevojave përkatëse,

marrjen e një feedback-u për shërbimet ekzistuese, si dhe ndryshimin e strategjive për parandalimin dhe trajtimin e problemit të dhunës.

Trafikimi dhe shfrytëzimi i të rinjve

- Përfshirja nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës e një programi informues mbi rrezikun e trafikimit dhe pasojave të tij në kurrikulat mësimore të ciklit arsimor parauniversitar dhe atij universitar brenda vitit 2007. Në këtë drejtim duhen rishikuar tekstet e përshtatshme si "Edukata qytetare", për të bërë të mundur përfshirjen në të të koncepteve dhe çështjeve të reja, si të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve, trafikimi dhe shfrytëzimi i qenieve njerëzore etj. (marrë nga strategjia e MASH-it)
- Organizim i përvitshëm nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve i një fushate kombëtare ndërgjegjësuese mbi rreziqet e trafikimit nëpërmjet shfaqjes së spoteve televizive, si dhe shpërndarjes së materialeve informuese. Ndërkohë, një përjasje krijuese ndaj konceptimit të fushatave të ndërmarra do të ishte edhe organizimi i një konkursi kombëtar me punime artistike nga të rinjtë e shkollave të mesme me tematikën e trafikimit të qenieve njerëzore.
- Angazhimi i Ministrisë së Brendshme për krijimin e 12 njësive rajonale për fëmijët dhe të rinjtë pranë çdo drejtorie të policisë së qarkut, duke filluar gjatë vitit 2007. Qëllimi kryesor i këtyre njësive do të jetë ndjekja e krimeve ndaj fëmijëve dhe të rinjve (nëpërmjet identifikimit të shpejtë të rasteve të trafikimit dhe abuzimit), marrja nën mbrojtje në kohë e viktimave, si dhe ndjekja e procesit penal në mënyrë profesionale. Nga ana tjetër, këto njësi do të luajnë një rol kryesor në parandalimin dhe ndjekjen e rasteve të përfshirjes së të rinjve në krime (drogat, krimet seksuale, krimet kundër personit.

Treguesit dhe burimet

Shëndeti riprodhues (lufta kundër HIV/AIDS dhe SST-ve)

Sensibilizimi për çështjet e shëndetit riprodhues dhe të edukatës seksuale të të rinjtë do të bëhet në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe fondacionet, mësuesit, OJF-t rinore.

Shtimi i numrit të qendrave që kryejnë testin e HIV/AIDS, të cilat do të kryejnë rolin e testimit dhe të këshillimit.

Nëpërmjet bashkëpunimit me qendrat rinore do të mundësohet dhënia e falas e mjeteve kontraceptive, si dhe shërbime gjinekologjike falas.

Përdorimi i kontraceptiveve – MICS 2005

Përqindja e femrave 15 –19 vjeçe të martuara/ bashkëjetesë, që përdorin të paktën një metodë kontraceptive: 35 %.

Përqindja e femrave 20-24 vjeçe të martuara/ bashkëjetesë, që përdorin të paktën një metodë kontraceptive: 42%.

Abuzimi me drogat

Nëpërmjet veprimtarive dhe trajnimeve si: ngritja e qendrave këshillimore për të trajtuar përdoruesit e rinj, trajnimi i mësuesve, përfshirja e psikologut dhe punonjësve socialë në shkolla e komunitete të zonave rurale, ekspozita pikturë, drama e teatro me këtë temë, shpërndarje materialesh promocionale, seminare informuese, debate televizive, shkolla verore për edukimin etj., do të synohet ulja e numrit të të rinjve që janë përdorues të drogës dhe parandalimi i brezit të ri për të qenë përdorues.

Kriminaliteti rinor

Ndërgjegjësimi e parandalimi i rasteve të dhunës ndaj të miturve dhe të rinjve do të realizohet nëpërmjet veprimtarive të ndryshme si fushata ndërgjegjësuese për të drejtat e të rinjve.

Duke qënë se nuk ka qendra për trajtimin e të rinjve të dhunuar gjatë vitit 2006-2007, do të hapet një qendër trajnimi, ku do të funksionojë dhe një ekip multidisiplinor, me anë të saj synohet të ulet numri i të dhunuarve dhe të parandalohet numri i të dhunuarve.

Kryerja e një studimi për njohjen e problemit në zonat rurale dhe urbane të rajonit me target viktimat, prindër, mësues, institucione.

Trafikimi dhe shfrytëzimi i të rinjve

Takimet, seminarët edukuese, shpërndarja e materialeve promocionale kurseve verore për të rinjtë në risk, të cilët do të informohen dhe do të për trafikimin dhe rrezikun ndaj tij, të gjitha këto do të shërbejnë si një fushatë sensibilizuese kundër trafikimit të të rinjve.

Do të rritet numri i seminareve edukative në zonat rurale të vendit, si dhe trajnime ligjore, psikosociale, mjekësore, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

V. REKREACIONI RINOR DHE KOHA E LIRË

1. Karta e Studentit
2. Koha e lirë, sporti dhe kultura
3. Edukimi dhe aksioni mjedisor
4. Të rinjtë dhe turizmi rinor

KUSHTET AKTUALE

Karta e Studentit

Një pengesë, në gjëndjen ekonomike të të rinjve si konsumatorë, është prirja për çmime të larta të tregut të shërbimeve dhe produkteve për ta. Ndërkohë që në perëndim të rinjtë përveçse kanë sjellje më të shëndetshme konsumatore, vetë tregu ka krijuar avantazhe të shumta, sidomos për pjesën që nuk është ende gati për tregun e punës si pasojë e politikave ndërsektoriale. Modelet e kartës europiane të të rinjve “EURO <26”, “ISIC” etj. janë modele sesi tregu mund të ofrojë shërbime me çmime të reduktuara për kategori bazë të të rinjve që nuk janë ende në gjendje të gjenerojnë të ardhura, për të kënaqur të gjitha nevojat e tyre social-ekonomike.

Gjithashtu, ndryshe nga tregu në vende të Bashkimit Europian, tregu shqiptar nuk krijon avantazhe për nevojat ekonomike të të rinjve, por edhe aftësia konsumatore e të rinjve është një avantazh. Një nga çështjet, e cila është trajtuar me përparësi në perëndim është edhe mbështetja e lëvizjes rinore, ku kartat rinore luajën një rol të madh avantazhues të rinisë shkollore dhe studentore, ndërkohë që të rinjtë shqiptarë detyrohen të përballen me kushte të rënda financiare, kur ndërmarrin udhëtime jashtë Shqipërisë.

Element tjetër rëndues është tregu shqiptar i udhëtimeve dhe i turizmit të brendshëm, ku mungon plotësisht përvoja e çmimeve të ulura për të rininë shkollore dhe universitare, element që ndikon drejtpërdrejt në kufizimin e shfrytëzimit të këtij tregu nga të gjithë të rinjtë. Së fundmi, vlen të përmendet se Shqipëria është i vetmi vend në Europë ku nuk ka asnjë *Youth Hostel*.

Koha e lirë, sporti dhe kultura

Një aspekt tejet kritik i periudhës së tranzicionit politik, ekonomik dhe social-kulturor të vendit, pas rrëzimit të sistemit totalitar komunist, lidhet me uzurpimin dhe degradimin progresiv të hapësirës publike në

dispozicion të veprimtarive rekreative për fëmijët dhe të rinjtë. Në veçanti procesi i privatizimit është karakterizuar në një pjesë të konsiderueshme nga interesa të ngushtë dhe abuzimit me menaxhimin e mjediseve publike për përfitim individual.

Kështu, karakteristikë e zhvillimeve të periudhës pas vitit 1990 është përvetësimi i zonave të gjelbëra dhe i hapësirave të destinuara për rekreacionin e të rinjve – si për shembull përvetësimi i qendrave rinore, bibliotekave komunitare, parqeve dhe këndeve të lojërave.

Shndërrimi i këtyre mjediseve publike në hapësira për veprimtari dhe biznese private nënkuptoi tkurrjen e sipërfaqes së gjelbër përmes betonimit masiv, si dhe zhdukjen e pjesës më të madhe të vendeve, ku fëmijët dhe të rinjtë mund të zhvillonin veprimtari argëtuese dhe sportive gjatë kohës së lirë. Shumë prej këtyre mjediseve publike u shndërruan në kafene, bilardo ose lojëra fati – duke iu imponuar kështu brezave të rinj si forma të reja socializimi, që në një pjesë të madhe shpjegojnë problemet e shumta që prekin të rinjtë sot, si apatia dhe mungesa e interesit për edukimin, abuzimi me drogat, konfliktet, si dhe forma të ndryshme të kriminalitetit rinor.

Vlen për t'u theksuar se një rol vendimtar në këto zhvillime negative ka luajtur mungesa e një vizioni dhe interesi të qensishëm, për të ruajtur dhe zhvilluar hapësirat për rekreacionin rinor. Në këtë drejtim, situata aktuale shpjegohet nga kombinimi i faktorëve të tillë si praktikat korruptive dhe abuzuese nga instanca shtetërore të niveleve të ndryshme, interesat për përfitim individual nga ana e aktorëve të biznesit privat, si dhe urbanizimi masiv dhe intensiv në mungesë të një plani rregullues.

Krahas këtyre faktorëve, mungesa e theksuar e mundësive për rekreacionin rinor lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe me burimet financiare dhe njerëzore shumë të kufizuara, të cilat janë vënë dispozicion nga institucionet shtetërore. Në këtë kontekst, vlen të përmendet roli kyç i shoqërisë civile në përgjithësi dhe OJF-ve rinore në veçanti për mbushjen e këtij vakumi nëpërmjet projekteve dhe programeve të shumta - të cilat në pjesën më të madhe janë mbështetur nga organizata ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri dhe rajon, si dhe në një masë më të vogël nga biznesi privat në vend.

Edukimi dhe aksioni mjedisor

Një nga aspektet më problematike të periudhës së tranzicionit pas vitit 1990 është dëmtimi i burimeve të pasura natyrore në territorin e vendit dhe degradimi i vazhdueshëm i mjedisit rural dhe urban. Në veçanti, shfrytëzimi pa kriter dhe i paligjshëm i burimeve natyrore ka çuar në dëmtimin e ekosistemeve vendore, duke sjellë kështu kosto të mëdha

mjedisore dhe ekonomike. Ndërkohë uzurpimi i hapësirave të gjelbëra në qendrat urbane dhe fragmentimi i tokave bujqësore në zonat rurale kanë çuar në zvogëlimin e vlerës së kapitalit natyror, si dhe në uljen e cilësisë së mjedisit. Elemente kritike të këtyre dukurive janë ulja e rendimentit të tokave bujqësore, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, humbja e biodiversitetit dhe pakësimi i burimeve natyrore që gjenerojnë të mira materiale, si pasojë e shpyllëzimeve pa kriter dhe shtimit të erozionit të tokës. Ndikimet negative nga ana e veprimtarive të ndryshme njerëzore janë, gjithashtu, mjaft të dukshme në ndërhyrjet e pakontrolluara në infrastrukturën ekzistuese (si në rrjetin e ujit të pijshëm, ashtu edhe në atë të ujërave të zeza), në keqadministrimin e mbeturinave urbane, si dhe ndotjen e ajrit si pasojë e shtimit drastik të transportit privat.

Të rinjtë përbëjnë një kategori shumë të prekur nga këto zhvillime mjedisore gjatë periudhës së tranzicionit. Përkeqësimi i mjedisit ka sjellë jo vetëm uljen e cilësisë së jetesës, por edhe ekspozimin ndaj një risku më të madh për shëndetin. Në veçanti, jetesa e brezave të rinj, që rriten në rrethina të qendrave urbane, është e ndikuar në mënyrë më të theksuar nga degradimi mjedisor prej ndotjes drastike të ajrit, aksesit të kufizuar ndaj ujit të pijshëm të kontrolluar dhe cilësor, mungesës së hapësirave të gjelbëra, si dhe keqadministrimit të plehrave. Në këtë kontekst vlen të theksohet se krahas uljes së cilësisë së jetesës, problematika e degradimit mjedisor ka një përmasë tejet të rëndësishme ekonomike. Mostrajtimi i ndotjes alarmante të hapësirave të dendura urbane, ashtu edhe atyre rurale – dhe në veçanti të ndotjes së ajrit – do të implikojnë kosto të mëdha për ekonominë e vendit lidhur me nevojën e trajtimit në të ardhmen të një shumësie problemesh shëndetësore, të cilat do t'i përjetojnë fëmijët dhe të rinjtë e sotshëm kur të rriten.

Në këtë kontekst, duhet theksuar se këto dukuri të përkeqësimit të mjedisit janë ngushtësisht të lidhura me faktin se institucionet vendore dhe qendrore nuk janë të pajisura në mënyrën e duhur, si nga pikëpamja e kapaciteteve njerëzore, ashtu edhe të burimeve kapitale, për menaxhimin në mënyrë të efektshme të problematikës së gjerë mjedisore. Pavarësisht plotësimeve dhe përmirësimeve në vitet e fundit, kuadri ligjor e rregullator ende nuk i përgjigjet kërkesave të kohës, ndërsa monitorimi dhe aftësia për të detyruar zbatimin e ligjit lënë shumë për të dëshiruar.

Të rinjtë dhe turizmi rinor

Shqipëria është një vend i bukur dhe magjepsës. Ajo ka një gamë të gjerë atraksionesh historike, kulturore dhe natyrore që përbëjnë një interes të madh për turistët ndërkombëtarë. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në dhjetor të vitit 2005 ka shpallur Strategjinë e Turizmit Mjedisor dhe Kulturor . Duke qenë se turizmi dhe kultura janë parë si dy koncepte të përafërta , kjo strategji bashkëngjitur

me një planveprim, ka si synim që Shqipëria të shndërrohet në një destinacion turistik, duke shfrytëzuar jo vetëm atraksionet natyrore, por dhe vlera të shumta të traditës dhe kulturës.

Koncepti i turizmit kulturor dhe ekoturizmit : Çdo destinacion turistik është i përbërë nga një sërë faktorësh që e bëjnë atë të dallueshëm nga të tjerë, siç janë: mënyra e jetesës, trashëgimia, veprimtaria kulturore, peizazhi, flora dhe fauna, që janë bazë për zhvillimin e produktit të destinacionit.

Në këtë kontekst është e rëndësishme përfshirja e rinisë si pjesa më aktive në nisma dhe veprimtari kulturore me qëllim promovimin e rëndësisë së trashëgimisë kulturore dhe zhvillimin i turizmit kulturor, si dhe ekoturizmin si një bazë për mundësi të reja zhvillimi.

Kuptimi dhe vlerësimi nëpërmjet “zbulimit “ të Shqipërisë rithekson dhe njëherë rëndësinë e shkëmbimeve rinore (seminare, ekskursione, vizita në muze ose vende historike, festa etj.), ku protagonistë do të jenë vetë të rinjtë, për të zbuluar vlerat dhe traditat e vendeve të tyre. Kjo do të shërbejë për njohjen dhe përmirësimin e imazhit.

VIZIONI, PËRPARËSITË DHE QËLLIMET STRATEGJIKE

Karta e Studentit

Kombinuar me rëndësinë e aksesit ndaj veprimtarive rekreative për rininë, karakteristikat socio-ekonomike e kësaj kategorie kërkojnë që të rinjtë të kenë lehtësira dhe avantazhe të veçanta nëpërmjet futjes në qarkullim të Kartës së Studentit.

Qëllim tjetër strategjik përbën bashkëpunimi i institucioneve qeveritare dhe joqeveritare me subjektet private, për të ndërtuar infrastrukturën ligjore dhe financiare, të nevojshme për të promovuar statusin social-ekonomik të të rinjve nëpërmjet kartave rinore dhe studentore, konform standardeve ndërkombëtare të materializuara në “EURO <26”, “ISIC” etj. Gjithashtu, institucionet qeveritare duhet të nxisin krijimin e lehtësive ekonomike në lëvizjen e të rinjve dhe kushtet akomoduese.

Koha e lirë, sporti dhe kultura

Vizioni i Strategjisë bazohet në vlerësimin e veprimtarive të kohës së lirë si tejet të rëndësishme për zhvillimin psikologjik, konjektiv dhe fizik të brezave të rinj. Kështu, zhvillimi i lojërave zbavitëse dhe i veprimtarive fizike, pjesëmarrja në veprimtari artistike dhe kulturore, si dhe angazhimi në shërbime komunitare konsiderohen si veprimtari socializuese dhe formuese me vlera të qenishme për brezat e rinj. Ndërkohë që pjesëmarrja në të tilla veprimtari rekreative luan një rol shumë të rëndësishëm që të rinjtë të qëndrojnë larg veprimtarive dhe

sjelleve me risk. Në të vërtetë, ka ardhur gjithnjë e në rritje afirmimi i lidhjes midis veprimtarive rekreative me zhvillimin e vlerave dhe parimeve individuale, si besimi, respekti, integriteti, qëndrueshmëria dhe vetëvlerësimi, si dhe zhvillimi i koncepteve pozitive dhe aftësive sociale kryesore si toleranca dhe vlera e punës në grup.

Në këtë kontekst, përparësi përbën hartimi dhe zbatimi i politikave të qarta, të cilat mbështesin zhvillimin e hapësirave dhe kushteve të nevojshme për veprimtari rekreative, me synim sigurimin e aksesit sa më të madh, si nga djemtë, ashtu edhe nga vajzat. Qëllim strategjik në këtë drejtim përbën ripërvetësimi i hapësirave publike të uzurpuara gjatë viteve të tranzicionit dhe investimi në hapjen e qendrave rinore dhe bibliotekave komunitare në të gjithë vendin.

Përparësi i duhet dhënë integritit të nevojave rekreative të të rinjve në procesin e planifikimit urban dhe rural. Gjithashtu, qëllim strategjik përbën angazhimi i instancave shtetërore të niveleve të ndryshme, për të mbështetur OJF-të rinore me burimet e nevojshme financiare dhe teknike për realizimin e projekteve dhe të programeve rekreative me pjesëmarrje të gjerë rinore.

Edukimi dhe aksioni mjedisor

Vizioni i Strategjisë për edukimin dhe aksionin mjedisor lidhet me integrimin e koncepteve dhe të praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programet, të cilat kanë në fokus rininë. Në veçanti, angazhimi i të rinjve në mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit duhen parë si faktorë thelbësorë për rritjen e cilësisë së jetesës, si dhe për menaxhimin e frytshëm të burimeve natyrore, të cilat gjenerojnë të mira materiale.

Drejtim përparësor i këtij vizioni strategjik është promovimi i një kulture të zhvillimit të qëndrueshëm të brezat e rinj nëpërmjet edukimit dhe aksionit mjedisor. Rol kyç do të luajë përfshirja në programet mësimore në të tri ciklet arsimore të edukimit mjedisor, me qëllim formimin e të rinjve, të cilët janë të ndjeshëm ndaj problemeve të mjedisit. Një tjetër qëllim strategjik do të jetë përfshirja e drejtpërdrejtë e sa më shumë të rinjve në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe të programeve mjedisore – me synim edhe garantimin e aksesit të barabartë si për vajzat dhe për djemtë ndaj pronës private dhe burimeve natyrore.

Për angazhimin sa më efektiv në trajtimin e problematikës së gjerë të zhvillimit të qëndrueshëm, domosdoshmëri përbën bashkëpunimi shumëpalësh midis institucioneve shtetërore të niveleve të ndryshme, shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare që kanë në fokus mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm, si dhe komunitetin e biznesit. Në këtë kontekst, duhet theksuar se përparësi të tjera strategjike përbëjnë grumbullimi i të dhënave dhe kryerja e studimeve të

vazhdueshme, të cilat monitorojnë gjendjen e mjedisit në vend dhe efektet e projekteve dhe të programeve të ndërmarra në këtë sektor.

Te rinjtë dhe turizmi rinor

Vizioni i Strategjisë bazohet në vlerësimin e veprimtarive të kohës së lirë për të rinjtë si tejet të rëndësishme për zhvillimin e turizmit në Shqipëri. Kështu, zhvillimi i veprimtarive rinore, i shkëmbimeve rinore, pjesëmarrja në veprimtari artistike dhe kulturore, si dhe angazhimi në shërbime komunitare konsiderohen si veprimtari socializuese dhe njohëse me burimet e pasuritë e vendit.

Të rinjtë janë të parët të cilët do të promovojnë rëndësinë e trashëgimisë natyrore dhe kulturore si bazë për mundësi të reja zhvillimi. Duke qenë se të rinjtë tentojnë të kombinojnë veprimtari të ndryshme gjatë vizitave të tyre, ata zakonisht i shohin veprimtaritë e ndryshme natyrore dhe kulturore si pjesë e destinacionit. Monumente të ndryshme kulturore dhe arkeologjike të vendit tonë si : Butrinti (Sarandë), Bylysi (Ballsh), Apollonia (Fier) etj. mund të bëhen shumë atraktive për të rinjtë europianë nëpërmjet projekteve dhe veprimtarive të ndryshme.

Turizmi kulturor, gjithashtu, i përket një udhëtimit të përgjegjshëm si mjedisor dhe social në zona natyrore ose pranë tyre, që promovon ruajtjen, ka impakt të ulët të vizitorëve dhe kujdes për përfshirjen e komunitetit vendor.

Përparësi përbën krijimi i hapësirave dhe mundësive për kulturat e ndryshme që të shprehin vetveten, në veçanti zakonet dhe traditat e rajoneve të ndryshme të vendit.

Nëpërmjet infrastrukturës ekzistuese të rinjtë të kenë mundësi të zhvillojnë veprimtari (aktivizim rinor), si lëvizja me kafshë (trending), alpinizëm, zhytje, peshkim, arkeologji. Nëpërmjet veprimtarive të përvitshme rinore me sporte alternative, të rinjtë nga Europa dhe Ballkani kanë mundësi të shohin dhe të eksplorojnë vetë natyrën e bukur shqiptare.

POLITIKAT

Karta e Studentit

- Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në bashkëpunim me ministri të linjës duhet të nxisin dhënien të rinjve shqiptarë të Kartës së Studentit, Kartën e të Riut sipas standardeve të “EURO <26” dhe “ISIC”. Organizatat rinore nxiten të bashkëpunojnë, për të ndërmarrë nisma të implementimit të këtyre standardeve, duke bashkëpunuar me organizatat ndërkombëtare rinore si EYCA<26, organizatat e ISIC etj.

- Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit, Telekomunikacionit dhe Punëve Publike duke të nxisin në praktikat e licencimit dhe të monitorimit krijimin e avantazheve ekonomike për udhëtimet dhe turizmin rinor.
- Nxitja e krijimit të *'youth hostel-eve'*, duke parë edhe mundësinë e subvencionimit qeveritar për to, konform praktikave europiane në këtë fushë.

Edukimi dhe aksioni mjedisor

- Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit nëpërmjet bashkëpunimit ndërsektorial dhe angazhimit të drejtpërdrejtë të të rinjve.
- Bashkërendimi efektiv i punës së institucioneve shtetërore në nivel vendor dhe qendror, i organizatave ndërkombëtare dhe OJF-ve rinore që operojnë në këtë sektor, me qëllim angazhimin e komuniteteve vendore në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe të programeve me fokus zhvillimin e qëndrueshëm.
- Integrimi i edukimit mjedisor në kurrikulën shkollore në të tri ciklet arsimore, si dhe trajnimi i mësuesve për problematikën e zhvillimit të qëndrueshëm.
- Mbështetja teknike dhe financiare për organizatat rinore mjedisore për edukimin joformal mjedisor të të rinjtë dhe angazhimin e tyre të drejtpërdrejtë në projekte për mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit.
- Realizimi i fushatave ndërgjegjësuere për përgjegjësinë qytetare për mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit nëpërmjet përgatitjes dhe shpërndarjes së materialeve informative mbi çështjet mjedisore në vend dhe aspekteve globale të mjedisit.
- Trajnimi i gazetarëve dhe bashkëpunimi i ngushtë me mediat elektronike dhe të shkruara me qëllim përmirësimin e rolit të tyre në trajtimin e problematikave mjedisore dhe në promovimin e kulturës së zhvillimit të qëndrueshëm në opinionin publik dhe të të rinjtë në veçanti.
- Promovimi dhe mbështetja e programeve që mundësojnë pjesëmarrjen e të rinjve në mbjelljen e pemëve për gjelbërimin e hapësirave urbane dhe rigjenerimin e zonave pyjeve të dëmtuara.
- Hartimin dhe zbatimin e programeve pilot për reciklimin nëpërmjet bashkëpunimit me institucione arsimore për angazhimin e

drejtpërdrejtë të të rinjve dhe me synim zgjerimin e këtyre programeve në komunitet.

- Grumbullimi i vazhdueshëm i informacionit për problematikën mjedisore dhe realizimi i studimeve për zhvillimin e qëndrueshëm, me qëllim krijimin e një baze të dhënash mbi situatën e mjedisit në vend, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të projekteve dhe programeve të ndërmarra në këtë sektor.

Të rinjtë dhe turizmi rinor

- Promovimi i rëndësisë së trashëgimisë natyrore dhe kulturore nga të rinjtë.
- Organizimi i festivaleve të ndryshme me fokus diversitetin e këngës, pasurinë e kulturave dhe të traditave e vlerave të ndryshme kombëtare.
- Veprimtari të përvitshme rinore me sporte alternative, me të rinjtë nga Europa dhe Ballkani, duke u krijuar mundësinë të shohin dhe të eksplorojnë vetë natyrën e bukur shqiptare.
- Përmirësimi i imazhit të Shqipërisë në botë nëpërmjet nismave dhe veprimtarive të ndryshme rinore.
- Ndërtimi i hostele-ve për të rinjtë në sa më shumë vende me interes historik ose kulturor, për të promovuar turizmin rinor, duke përfshirë këtu turizmin kulturor dhe atë malor.
- Nxitja e organizatave rinore me fokus në veprimtaritë rekreative.
- Përfshirja në të mësuarin dhe në vlerësimin e traditës së pasur në art, kulturë.
- Të nxisim dhe të lehtësojmë nëpërmjet vullnetarizmit rinor, vizita në monumentet e kulturës, duke angazhuar të rinjtë të kujdesen për zona të tilla si Butrinti, që nëpërmjet përfshirjes së tyre ata të fasilitojnë guidat turistike dhe të kujdesen për mjedisin.
- Promovimi i rëndësisë së trashëgimisë natyrore dhe kulturore, si dhe zhvillimi i turizmit kulturor dhe ekoturizmit, si një bazë për mundësi të reja zhvillimi i turizmit rinor.

VI. TË RINJTË SHQIPTARË: QYTETARËT E RINJ EUROPIANË

1. Edukimi qytetar dhe demokracia
2. Roli i rinisë në promovimin e të drejtave të njeriut
3. Vullnetarizmi rinor
4. Teknologjia e informacionit dhe interneti
5. Lëvizja e lirë në hapësirën europiane

KUSHTET AKTUALE

Edukimi qytetar dhe demokracia

Edukimi për qytetarinë demokratike përbën një çështje komplekse, e cila rezulton si një nga problematikat më të rëndësishme për proceset e transformimit politik, socio-ekonomik dhe atij kulturor të shoqërisë shqiptare drejt standardeve të demokracive të vendeve të zhvilluara europiane. Modelet e sjelljes së pranueshme dhe pro sociale, të cilat kontribuojnë në respektimin e të drejtave të njeriut dhe në forcimin e një shoqërie demokratike, gjënden tepër rrallë në mjediset e ngushta mikrosociale, përfshirë këtu edhe familjen. Ndër faktorët e shumtë që kanë ndikuar negativisht në konsolidimin e edukatës dhe të angazhimit qytetar janë edhe lëvizjet urbane të popullsisë, tensioni i vlerave dhe kulturave, papunësia, kërkesat dhe ambiciet për karrierë, numri i lartë i divorceve dhe i prindërve emigrantë.

Problem me rëndësi gjatë periudhës së tranzicionit ka qenë bashkëpunimi sipërfaqësor ndërmjet hartuesve të politikave dhe programeve për edukimin qytetar dhe mësuesve, prindërve, komunitetit dhe shoqërisë civile. Gjithashtu, ka qenë problematike mungesa e një standardi shtetëror kombëtar, si dhe mungesa e mbështetjes financiare për zbatimin e programeve të edukimit qytetar. Në këtë drejtim ka munguar edhe mbështetja për edukimin dhe angazhimin e barabartë të vajzave në jetën publike si një proces i domosdoshëm i një shoqërie demokratike.

Vlen të përmendet edhe mungesa e vazhdimësisë dhe qëndrueshmërisë së programeve pilot, së bashku me mungesën e monitorimit të vazhdueshëm të efekteve të këtyre veprimtarive të realizuara në terren. Problem, gjithashtu, përbën edhe dobësia e sistemit të kualifikimit shtetëror të mësuesve për mësimdhënien e qytetarisë demokratike. Ndërkohë pothuaj ka munguar tërësisht mbështetja nga pushteti vendor për institucionet arsimore, në drejtim të krijimit të mjediseve qytetare.

Një tjetër përmasë problematike ka qenë edhe përfshirja e pamjaftueshme e qeverisë së nxënësve në jetën shkollore dhe komunitare.

Roli i të rinjve në promovimin e të drejtave të njeriut

Shoqëria shqiptare nuk është e informuar mjaftueshëm për të drejtat e njeriut dhe aq më pak për të drejtat e fëmijës. Kjo është një frymë e përgjithshme që i shoqëron familjet shqiptare dhe kjo mbase si pasojë e të kaluarës sonë. Të rinjtë shqiptar, si pjesë e shoqërisë, janë njohës të mirë të detyrimeve të tyre në familje, shkollë ose komunitet, por nuk janë njohës, dhe aq më pak mbrojtës, të të drejtave të tyre të garantuara me ligj. Mosrespektimi i të drejtave të njeriut ose të Konventës për të Drejtat e Fëmijës mund të vijë si pasojë e mungesës së informacionit, por shpesh vjen edhe si pasojë e rrethanave sociale ose ekonomike.

Shkeljet e të drejtave të njeriut bëhen më të dukshme gjatë ndalimit të të rinjve nga policia gjatë paraburgimit, gjatë vuajtjes së dënimit etj. Megjithatë, duhet pa tjetër të theksojmë progresin e dukshëm që është bërë në këtë fushë gjatë vitit të fundit.

Gjithashtu, shpesh të rinjtë përballen me shkeljen e të drejtave të tyre edhe në institucione publike. Do të përmendim këtu, si tepër të dëmshme, shkeljet që bëhen në institucionet arsimore, pikërisht aty ku të rinjtë edukohen dhe mësojnë këto të drejta. Përmirësimet janë të dukshme, por ende nuk mjafton, pasi ajo çka duhet vërtet të ndryshojë është perceptimi i shoqërisë për këto të drejta dhe më pas mund të kërkojmë respektimin e tyre. Faktet kanë treguar se të rinjtë e kanë më të lehtë se sa të rriturit të ndryshojnë dhe t'i përshtaten progresit. Për këtë arsye, por jo vetëm të rinjtë, janë ata që duhet të bëhen promotor të të drejtave të njeriut, pasi vetëm kështu mund të shpresojmë për një përmirësim të gjëndjes në të ardhmen.

Vullnetarizmi rinor

Vullnetarizmi në Shqipëri gjatë viteve të tranzicionit ka vuajtur nga ngarkesat negative të mbartura nga përvoja e “vullnetarizmit të detyruar” përgjatë periudhës së regjimit komunist. Kështu, modifikimi i këtij perceptimi negativ ka përbërë një nga përmasat më kritike të angazhimit të organizatave që kanë punuar për krijimin e një kulture të re të pjesëmarrjes qytetare nëpërmjet përfshirjes së një numri sa më të madh të rinjsh në baza plotësisht vullnetare. Në të vërtetë, shoqëria civile ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme nëpërmjet organizimit të një game të gjerë veprimtarish sociale vullnetare – punë, e cila po të matej financiarisht ka gjasa të ndikonte opinionin publik për vlerat e qenësishme të vullnetarizmit në Shqipëri.

Megjithatë, situata aktuale karakterizohet nga mungesa e një pjesëmarrjeje të gjerë të rinjve në veprimtari vullnetare, si dhe mungesa e orientimit të atyre të rinjve që kontribuojnë me punë vullnetare drejt nevojave përparësore. Ndërkohë mungojnë jo vetëm kapacitetet organizative të OJF-ve rinore, për të shfrytëzuar potencialin ekzistues të komunitetit rinor për të ofruar shërbime vullnetare, por edhe shkalla e duhur e burimeve financiare dhe logjistike për mbështetjen e ndihmesës vullnetare.

Pjesë tjetër problematike e konsolidimit të kulturës së vullnetarizmit lidhet me mungesën e një klime bashkëpunimi mes subjekteve që kontribuojnë në shërbimet vullnetare, si dhe niveli i ulët i shkëmbimeve ndërkombëtare të vullnetarëve. Gjithashtu, mungojnë edhe politikat promovuese ndaj vullnetarizmit rinor, të cilat janë të domosdoshme për edukimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit, për të vlerësuar punën vullnetare.

Pjesë tjetër problematike e konsolidimit të kulturës së vullnetarizmit, krahas të shkuarës komuniste, përbën edhe perceptimi i pabazë se ekonomia e tregut e përjashton vullnetarizmin. Ndërkohë, efekt negativ ka patur edhe kombinimi i shkallës së pamjaftueshme të ekspertizës dhe kapaciteteve organizative të shoqërisë civile për menaxhimin e vullnetarëve dhe mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare dhe logjistike për mbështetjen e ndihmesës vullnetare.

Teknologjia e informacionit dhe interneti

Interneti në Shqipëri është një dukuri e re, e cila nga viti në vit po gëzon progres të vazhdueshëm. Fundi i viteve '90 solli linjat e para të internetit në Shqipëri dhe këto ishin një privilegj i disa organizatave ndërkombëtare tepër të fuqishme. Disa nga website-t e para shqiptare u ndërtuan në vitin 2000: www.albasoul.com, www.shqipëria.com etj. Ndërsa 3 vjet më vonë u ndërtua projekti i parë online i cili synonte ngritjen e një portali rinor (www.syri.org) dhe një rrjeti website-sh të shkollave të mesme të Tiranës (www.shkollat.net). Kjo solli një revolucion në informacionin që jepej online, siç ishte prezantimi i shkollave të mesme ose ngritja e urave të komunikimit ndërmjet të rinjve nëpërmjet teknologjisë së informacionit.

Vit pas viti Shqipëria ka bërë progres përse i përket përdorimit të internetit dhe komunikimit online. Por megjithëkëtë, numri i të rinjve që kanë akses të vazhdueshëm në internet mbetet tepër i vogël, krahasuar me vendet e tjera perëndimore. Investimi i Qeverisë, për të sjellë internet në çdo klasë, pa dyshim që do të përmbys gjëndjen aktuale të përdorimit të internetit nga të rinjtë, por edhe grupmoshat e tjera të shoqërisë.

Aktualisht jemi ende mbrapa përsa i përket përdorimit të teknologjisë së informacionit për të ofruar shërbime. Ende institucionet nuk janë në gjendje të ofrojnë shërbime online. Gjithashtu, është tepër i ulët numri i organizatave rinore, institucioneve ose i shkollave dhe universiteteve që kanë website dhe akoma më i vogël i atyre që e përdorin këtë si një mënyrë efektive të komunikimit me të rinjtë, duke ofruar informacion të përditësuar dhe të plotë. Kjo situatë ka ndikuar në aftësitë e ulëta të studentëve shqiptarë për të bërë *researche online*, gjë të cilën bashkëmoshatarët e tyre nëpër botë e kanë themelin bazë të studimit dhe edukimit.

Në këtë kohë në shumë vënde të botës të rinjtë kanë mundësinë e edukimit, arsimimit dhe kualifikimit nëpërmjet internetit, gjë e cila duket tepër larg për kushtet e vëndit tonë. Edhe ata të rinj të rinj që kanë akses në internet shpesh informacionet e nevojshme i gjejnë në ëbsite të huaja, ndërsa ëbsitet shqiptare shpesh përmbajnë informacion të pakontrolluar dhe të parëndësishëm.

VIZIONI, PËRPARËSITË DHE POLITIKAT

Edukimi qytetar dhe demokracia

Vizioni strategjik ka parasysh edukimin për qytetarinë demokratike si tejet të rëndësishëm për përfitim të njohurive dhe aftësive të nevojshme për pjesëmarrje në shoqërinë civile demokratike. Edukimi qytetar luan një rol kyç në konsolidimin e një shoqërie demokratike nëpërmjet ndikimit shumëpërmasor të brezat e rinj – si promovimi i dialogut dhe reflektimi kritik, zgjidhja e konflikteve nëpërmjet konsensusit dhe tolerancës, si dhe rritjes së vetëdijes për të drejtat dhe përgjegjësitë e secilit dhe normat e sjelljes në komunitet.

Përparësi në këtë drejtim përbën ndihmesa ndaj të rinjve, që të fitojnë njohuritë dhe vlerat themelore të qytetarisë demokratike, por edhe të zhvillojnë më tej aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme – në mënyrë të veçantë duke kapërcyer pengesat që krijojnë autoritetet fals, konformizmin dhe paragjykimet, si dhe mekanizmat që nxitin dhe justifikojnë racizmin, etnocentrizmin dhe format e tjera të shtypjes, të diskriminimit dhe të padrejtësive shoqërore.

Në këtë kontekst, qëllim strategjik përbën rritja e bashkëpunimit dhe e marrëdhënieve të ndërsjella midis institucioneve shtetërore të niveleve të ndryshme, shkollës dhe komunitetit, me synim edukimin e të rinjve për të pjesëmarrë aktivisht në jetën komunitare.

Rëndësi e veçantë i duhet dhënë rritjes së statusit dhe rolit të luajtur nga qeveria e nxënësve dhe OJF-të rinore në hartimin dhe zbatimin e projekteve në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar, të cilat krijojnë mundësi të barabarta për formimin qytetar dhe angazhimin e djemve dhe të vajzave. Në veçanti, qeveria e nxënësve duhet parë si një hap institucional pozitiv drejt demokratizimit të jetës shkollore dhe si një

partner për rritjen e pjesëmarrjes së gjerë dhe efektive të të rinjve në vendimmarrje dhe veprimtari në shkollë dhe komunitet.

Roli i rinisë në promovimin e të drejtave të njeriut

Edukimi me të drejtat e njeriut është një e drejtë themelore. Rritja e aksesit të rinisë për/dhe shkëmbimi i informacionit në fushën e të drejtave të njeriut, duhet të jetë një ndër përparësitë e politikave të institucioneve shtetërore, të shoqërisë civile dhe të vetë organizatave rinore shqiptare. Të gjithë të rinjtë, në varësi të moshës dhe të mundësive të tyre, duhet të përfshihen në veprimtaritë edukuese për të drejtat e njeriut. Ata duhet jo vetëm të kërkojnë respektimin e të drejtave të tyre, por edhe të angazhohen në realizimin praktik të tyre.

Edukimi i rinisë duhet të synojë jo vetëm njohjen me të drejtat e njeriut, por edhe rritjen e kapaciteteve të rinisë për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të tyre. Institucionet shtetërore duhet të marrin masa me karakter ligjor, administrativ dhe teknik në nivel kombëtar dhe vendor, me qëllim që rinia të përfshihet më mirë në procesin e edukimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe ato të rinisë në veçanti. Përfshirja e organizatave rinore në këtë proces është një tregues i rolit aktiv të rinisë. Ato duhet të mundësojnë përfshirjen aktive të rinisë në procesin e vendimmarrjes, në zbatimin, monitorimin dhe përmirësimin e veprimtarive që lidhen me edukimin e rinisë me të drejtat e njeriut.

Vizioni i strategjisë është promovimi dhe garantimi i të drejtave të njeriut si të drejta të pamohueshme. Për këtë arsye do të mbështeten organizatat rinore që punojnë në këtë fushë, studentët, juristët e rinj ose edhe të rinjtë e tjerë që duan të ndër marrin nisma për promovimin e të drejtave të njeriut, si dhe të monitorojnë respektimin e tyre.

Objektiv është jo vetëm informimi i të rinjve për të drejtat e tyre, por edukimi i tyre me këto të drejta dhe nxitja e tyre për t'u bërë agjentë të promovimit të të drejtave të njeriut dhe të respektimit të tyre. Studimi i gjendjes aktuale dhe hartimi i politikave, që synojnë përmirësimin e gjendjes, është një nga objektivat e kësaj strategjie. Implementimi i politikave alternative, i zbatimit të ideve të reja, si dhe sjellja e përvojave ndërkombëtare do të sjellë një përmirësim të dukshëm në informimin e të rinjve mbi të drejtat e tyre, por edhe për ndërgjegjësimin e tyre në zbatim të këtyre të drejtave. Gjithashtu, do të sjellë rezultat përdorimi i të gjitha metodologjive bashkëkohore për këtë qëllim, me synimin për të arritur te çdo i ri.

Objektiv parësor është edhe ngritja e infrastrukturës për denoncimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut, duke u dhënë mundësi të rinjve që zëri i tyre kundër padrejtësive të dëgjohet dhe të sjellë ndikim.

Qëllim strategjik është edukimi i të rinjve me shtetin juridik dhe ndërgjegjësimi i tyre për respektimin e të drejtave të njeriut, si të vetmen mënyrë për të arritur standardet e një shoqërie europiane.

Vullnetarizmi Rinor

Vizioni strategjik për vullnetarizmin rinor lidhet me konceptimin e vullnetarizmit si një komponent tejet i rëndësishëm në edukimin dhe formimin e të rinjve si qytetarë të angazhuar, të cilët ofrojnë shërbime komunitare dhe japin ndihmesa sociale me vlera të qenësishme.

Përparësi për Qeverinë Shqiptare përbën bashkëpunimi i ngushtë me pjesëmarrjen e OJF-ve rinore dhe të komunitetit të biznesit, si dhe sigurimi i asistencës së huaj teknike nga organizatat ndërkombëtare dhe në veçanti SNV-ja për hartimin dhe zbatimin e politikave të qarta për promovimin e kulturës dhe të praktikës së vullnetarizmit të rinjtë. Në këtë drejtim, qëllime strategjike me rëndësi janë krijimi i një kuadri ligjor për vullnetarizmin, përcaktimi i statusit të vullnetarit, realizimi i projekteve për menaxhimin sa më efektiv të ndihmesave vullnetare, si dhe sensibilizimi i opinionit publik për vlerat dhe dobinë e punës vullnetare.

Fushë përparësore e angazhimit të institucioneve qeveritare përbën përkrahja e orientimit dhe e mbështetjes së vullnetarëve për të ndihmuar grupe në nevojë – si fëmijët që jetojnë në kushte të vështira, pensionistët, individët me aftësi të kufizuara, pacientët në spitale ose mjedise shtëpiake dhe gratë që jetojnë në institucione (qendra rehabilitimi, burgje etj.). Në këtë kuadër, qëllimi strategjik me rëndësi të veçantë përbën mbështetja teknike dhe financiare e OJF-ve, të cilat mobilizojnë të rinjtë për të dhënë ndihmesa vullnetare, me synim forcimin e kapaciteteve të tyre organizuese dhe menaxhuese.

Teknologjia e informacionit dhe interneti

Vizioni i strategjisë është zhvillimi i teknologjisë së komunikimit dhe shfrytëzimi nga të rinjtë i një komunikimi sa më bashkëkohor dhe eficient. Është objektiv parësor përdorimi i teknologjisë së komunikimit online për të ofruar shërbime, si dhe për të rritur informacionin e nevojshëm për të rinjtë. Hartimi dhe implementimi i politikave që nxisin komunikimin online ose i krijojnë mundësi të rinjve për të përdorur internetin, është një objektiv parësor për Qeverinë. Interneti në çdo klasë është një sfidë, e cila do të përmbysë gjëndjen aktuale të përdorimit të internetit.

Përparësi është rritja e standardeve dhe ngritja e kapaciteteve, për të ofruar shërbime online për të rinjtë, si dhe për të ofruar edukim dhe kualifikim, duke përdorur teknologjinë e informacionit. Është përparësore ngritja e kapaciteteve dhe shfrytëzimi i atyre ekzistuese në mënyrë që e gjithë rinia dhe organizatat rinore të shfrytëzojnë

komunikimin online për një bashkëpunim sa më efektiv me njëri-tjetrin, por edhe për të rritur bashkëpunimin me të rinjtë në botë.

Qëllim strategjik është krijimi i mundësive për sa më shumë të rinj që të aksesojnë në internet nëpërmjet ngritjes së qendrave rinore të komunikimit, të cilat para së gjithash, do të shërbejnë si promotorë të ndryshimit.

POLITIKAT

Edukimi qytetar dhe demokracia

- Forcimi i bashkëpunimit midis të rinjve, shkollës, komunitetit të prindërve dhe OJF-ve dhe organizmave të tjerë vullnetarë, për të ndihmuar në zhvillimin e programeve të edukimit për qytetarinë demokratike dhe rritjen e përgjegjësisë për angazhimin në jetën komunitare.
- Fuqizimi i qeverisë së nxënësve si një strukturë autonome, e cila kontribuon në demokratizimin e jetës në shkollës dhe zhvillimin e veprimtarive komunitare – nëpërmjet përcaktimit të qartë të statusit të saj *vis-a-vis* organet e tjera vendimmarrëse në nivel shkolle, si dhe përmes mbështetjes së saj me burime teknike dhe financiare për krijimin dhe forcimin e kapaciteteve organizative.
- Rishikimi i lëndës së *Edukimit qytetar*, me synim përmirësimin e materialit didaktik dhe përqasjes ndaj zhvillimit të veprimtarive formuese për edukatën qytetare demokratike.
- Trajnimi i mësuesve dhe i trajnerëve për përvetësimin e njohurive dhe aftësive të nevojshme në fushën e edukimit qytetar.
- Zhvillimi i veprimtarive ndërgjegjësuese dhe informuese ku të rinjtë të mund të fitojnë njohuritë dhe vlerat themelore të qytetarisë demokratike nëpërmjet organizimit të fushatave sensibilizuese në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar.
- Realizimi i monitorimeve dhe vlerësimeve periodike për matjen e impaktit të veprimtarive dhe projekteve të ndërmarra në fushën e edukimit qytetar.

Roli i rinisë në promovimin e të drejtave të njeriut

- Angazhimi i institucioneve shtetërore për marrjen e masave me karakter ligjor, administrativ dhe teknik në nivel kombëtar dhe vendor për përfshirjen efektive dhe sa më të gjerë të të rinjve në edukimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe ato të të rinjve në veçanti.
- Bashkëpunimi i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe OJF-ve rinore që operojnë në këtë sektor për konceptimin dhe zbatimin e formave dhe metodave më të përshtatshme për edukimin e rinisë me aftësi

teorike dhe praktike për njohjen dhe mbrojtjen e të drejtave të të rinjve nëpërmjet programeve shkollore.

- Bashkërendimi i punës midis shkollës dhe organizatave të të drejtave të njeriut, me synim rritjen e aksesit të të rinjve në informimin për të drejtat e njeriut nëpërmjet publikimeve dhe veprimtarive, të cilat kanë forma të pëlqyeshme dhe të pranueshme nga të rinjtë.

POLITIKAT

- Organizimi i fushatave informuese për të rinjtë.
- Organizimi i botimeve të ndryshme për të theksuar rolin e respektimit të këtyre të drejtave dhe për të ndërgjegjësuar të rinjtë për të drejtat e tyre.
- Organizimi i një fushate kombëtare informuese dhe ndërgjegjësuese.
- Ndërtimi i një websit-i për të promovuar të drejtat e njeriut dhe për të denoncuar rastet e shkeljeve të tyre.
- Vendosja e një numri falas për të denoncuar rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut nga institucionet publike.
- Bashkëpunimi me organizatat rinore që mbrojnë të drejtat e të rinjve dhe të fëmijëve, institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe me juristët e rinj.
- Zhvillimi i disa studimeve për të matur shkallën e njohjes nga njerëzit dhe respektimin e këtyre të drejtave nga institucionet publike.
- Organizimi i tryezave të rrumbullakëta dhe workshop-eve për të prezantuar rezultatet e studimeve dhe për të diskutuar për hapat që duhen ndërmarrë.
- Bashkëpunimi me gazetatat rinore (gazetat e shkollave, gazeta vendore ose kombëtare), website rinore dhe me radio rinore për të promovuar te të rinjtë Konvetën e të Drejtave të Njeriut dhe ndërgjegjësimi i tyre për respektimin e këtyre të drejtave themelore.

Vullnetarizmi rinor

- Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese për rëndësinë dhe ndihmesat sociale të vullnetarizmit, me qëllim promovimin te brezat e rinj të kulturës së angazhimit qytetar përmes vullnetarizmit. Në këtë drejtim duhet punuar për edukimin e komunitetit dhe ndryshimin e mendësisë aktuale, me synim krijimin e një perceptimi pranues.
- Angazhimi i institucioneve shtetërore dhe i OJF-ve rinore për përgatitjen, miratimin dhe njohjen e statusit të vullnetarëve me fokus të veçantë statusin e të rinjve vullnetarë.
- Krijimi i Kartës së Vullnetarit për sigurimin e stimujve për periudhën gjatë së cilës të rinjtë kryejnë punë vullnetare, me qëllim formimin dhe

konsolidimin e vullnetarizmit rinor. Lehtësirat dhe shërbimet e veçanta do të përfshijnë transport vendor dhe kombëtar falas, sigurimin shëndetësor në rastet incidenteve në punë, si dhe çmime të reduktuara për veprimtari artistike dhe kulturore.

- Hartimi dhe zbatimi i politikave integruese për përmirësimin dhe forcimin e kapaciteteve për shfrytëzimin sa më optimal të potencialeve ekzistuese në komunitet për të dhënë shërbime vullnetare.
- Sigurimi i ndihmesës teknike dhe financiare për OJF-të rinore që mobilizojnë të rinjtë për të dhënë ndihmesa vullnetare me synim forcimin e kapaciteteve të tyre menaxhuese, si dhe rritjen e numrit të të rinjve vullnetarë dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara.
- Rritja e nivelit të shkëmbimeve vullnetare në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për të rinjtë nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë të instancave shtetërore, organizatave ndërkombëtare dhe aktorëve të shoqërisë civile që operojnë në këtë sektor.
- Oritentimi i ndihmesave të vullnetarëve drejt çështjeve më me rëndësi dhe nevojave më të mëdha nëpërmjet rritjes së informacionit mbi mundësitë për dhënien e ndihmesave vullnetare, si dhe forcimit të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit midis institucioneve dhe organizatave që angazhojnë të rinj vullnetarë.
- Kryerja e studimeve dhe grumbullimi i të dhënave statistikore për të orientuar dhe përmirësuar në vazhdimësi projektet dhe programet e ndërmarra në kuadrin e konsolidimit të vullnetarizmit rinor.

Teknologjia e informacionit dhe interneti

- Ndërtimi i një rrjeti kombëtar me website-t e shkollave të mesme.
- Ndërtimi i një rrjeti kombëtar me website-t e universiteteve shqiptare.
- Mbështetja dhe fuqizimi i qendrave rinore ose grupeve rinore që kanë për qëllim teknologjinë e informacionit.
- Ndërtimi i një website, i cili ofron shërbime për grupet rinore vulnerabël (këshillim online, informacion etj.).
- Ndërtimi i një portali kombëtar për organizatat rinore, ku të rinjtë, donatorët, po edhe të tretë të interesuar mund të gjejnë informacion për organizatat rinore, mund të prezantohen me punën e tyre, si dhe mund të krijojnë komunikim midis tyre.
- Ndërtimi i një portali të madh rinor, i cili synon edukimin e të rinjve, ofron shërbime online, përmban informacion tepër të rëndësishëm për të rinjtë, krijon mundësi komunikimi dhe shkëmbimi përvojash mes të rinjve, ngritjen e bashkëpunimit mes të rinjve shqiptarë me njëri-tjetrin ose të huaj, promovimin e Shqipërisë, turizmin dhe kulturën tonë etj.

- Ngritja e një qendre rinore komunikimi, e cila të shërbejë si promotore e kësaj frymë të të gjithë të rinjtë, po edhe të shërbejë si infrastrukturë që i jep mundësi të gjithëve për të hyrë në botën e internetit.

Treguesit dhe burimet

Karta e studentit

Shpërndarja e Kartës së studentit në të gjitha universitetet dhe pajisja e rregullt e çdo studenti me këtë kartë.

Si rrejdhojë, studentët do të kenë lehtësira ekonomike, sociale dhe kulturore, çka do të përmirësojë dukshëm standardet e tyre të jetesës.

Koha e lirë, sporti dhe kultura

Rritja e numrit të të rinjve që merren me veprimtari sportive dhe kulturore. Këto veprimtari do të zhvillohen nga MTKRS-ja në bashkëpunim me OJF-të rinore dhe institucione të tjera.

Veprimtaritë do të përqendrohen në qytete artdashëse si: Korça e Vlora, si dhe në ato qytete ku jeta kulturore-artistike është e varfër.

Edukimi dhe aksioni mjedisor

Rritja e numrit të trajnimeve dhe seminareve për aksionin mjedisor, rëndësinë e tij për një jetë më të shëndetshme të të rinjve.

Nëpërmjet veprimtarive dhe programeve që do të zbatohen për periudhën 2007-2011 synohet një rritje e numrit të të rinjve të edukuar me aksionin mjedisor në të gjitha rrethet e vendit, sidomos në ato qytete ku problemi është më emergjent.

Teknologjia e informacionit dhe interneti.

Gjatë periudhës 2007-2011 do të vihen në zbatim programe si: vendosja e internetit në të gjitha shkollat e mesme të Tiranës, me qëllim njohjen e të rinjve me informacionet e fundit të vendit dhe botës në internet.

Programe përparësore për Strategjinë Kombëtare të Rinisë

- Ngritja dhe forcimi i kapaciteteve të organizatave dhe strukturave rinore.
- Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje dhe në jetën publike.
- Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në luftën kundër korrupsionit.
- Rritja e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar (rajon e më gjerë).
- Informimi dhe integrimi i studentëve shqiptarë që jetojnë dhe studiojnë në botë.
- Nxitja dhe promovimi i vullnetarizmit rinor dhe roli i të rinjve në zhvillimin e vendit.
- Edukimi qytetar i të rinjve.
- Rritja e mundësive për informacion dhe punësim të të rinjve.
- Nxitja dhe promovimi i biznesit rinor dhe krijimi i mundësive të vetëpunësimit.
- Rritja dhe formimi profesional i të rinjve.
- Aftësimi si konsumatorë i të rinjve.
- Krijimi i mundësive rekreative për të rinjtë në Shqipëri.
- Përfshirja dhe krijimi i mundësive për veprimtaritë rekreative për grupet e marginalizuara të të rinjve (fëmijët që punojnë, të trafikuar, romë, egjiptianë, të dhunuar, me probleme socio-ekonomike, jetimët etj.).
- Edukimi dhe aksioni mjedisor i të rinjve.
- Parandalimi dhe trajtimi i abuzimit me drogat.
- Ndërgjegjësimi, parandalimi dhe trajtimi i rasteve të dhunës ndaj të miturve dhe të rinjve.
- Ulja e kriminalitetit rinor.
- Parandalimi i trafikimit të të rinjve.

- Sensibilizim për çështjet e shëndetit riprodhues dhe të edukatës seksuale te të rinjtë.

